

KOLË LUKA

### RASTE NDËRHYRJESH ADMINISTRATIVE NË TOPONIMINË E DEFTERIT TË SHKODRËS TË VITIT 1485

Dy kadastrat e Shkodrës të shekullit XV, ai i shtrirjes së Komunës së Shkodrës më 1416-1417 nën venedikasit, dhe tjetri i mbarë Sanxhakut Iskenderije më 1485 nën osmanët, na japin repertorin më të pasur të toponimeve dhe të antroponimeve në këtë shekull për vetë Shqipërinë, dhe ndoshta edhe për mbarë Ballkanin. Kadastri i Komunës së Shkodrës është ekzemplari i vetëm për mbarë Ballkanin, si thotë Šufflay, dhe ky u plotësua tani së fundi, me dy kadastra të tjerë, njëri i bërë 67 vjet më vonë se ai venedikas, më 1485, d.m.th. 6 vjet pas rënies së Shkodrës nën osmanët më 1479, dhe që u botua në fund të vitit të kaluar<sup>1</sup>; tjetri bëhet 97 vjet pas këtij të fundit, më 1582.

Sigurisht që këto dy kadastra të shekullit XV kanë nevojë për krahasime kritike dhe interpretime, aq më tepër që janë bërë nga të huaj. Vështirësitë e transkriptimit për emrat shqip, me kalimin nga një gjuhë në tjetrën, kanë krijuar mjaft asimilime fonetike që duhen krahasuar me emrat e sotëm dhe duhen interpretuar edhe në pikëpamje të vetë zhvillimit të gjuhës shqipe në këta pesë shekuj. Në qoftë se fonetika e venetishtes paraqet disa vështirësi për interpretimin e tyre, grafia turke ka vështirësi të shumta e të mëdha dhe takimet homonimike në të dyja rastet e ngatërrojnë punën edhe më tepër dhe duan shpjegim. Në këtë vështrim, vëmendja e parë ndalet në përkthimet ose zëvendësimet e thjeshta të emrave, që janë ndër dukuritë më të zakonshme në kadastrimet e bëra nga të huajt, si edhe në emërtimet e tjera, duke u nisur për shembull nga kulturat mbizotëruese të një vendi ose të vetë trevës, në emërtimet e reja të marra nga ndonjë patronim ose nga ndonjë tipar më i spikatur i vendit të ri të ngulimit, sepse vetë fshatrat, sidomos në raste pushtimesh, kanë herë-herë lëvizje. Këto rregullësi dihen edhe prej kadastrimeve të tjera, por kjo gjë ndjehet edhe më fort në viset e Shkodrës, sepse këtu pushtimi turk gjeti një qëndresë të fortë, me lëvizje të mëdha popullore. Ndjekja e toponimeve të këtyre kadastrave është edhe më interesante në pikëpamje të historisë, etnografisë, gjuhësisë dhe të disiplinave të tjera të afërta, aq më tepër që me këto kadastra kemi për këtë shekull ndoshta viset më të dokumentuara të mbarë Ballkanit.

Dihet se para pushtimit turk, që zëvendësoi pandërmjetësisht atë venedikas, viset e Shkodrës kanë qenë pushtuar disa heresh nga forma-

1) *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, I, S. Pulaha, Tiranë 1974 (më tutje: *Defteri 1485*).

cionet shtetërore sllave, të cilat i kanë mbajtur edhe për një kohë gjatë nën sundimin e tyre, ashtu si edhe vise të tjera të Shqipërisë. Prandaj, edhe makrotoponimia ka trashëguar prej tyre mjaft emra vendesh në atë gjuhë, të cilët jo gjithherë duhen marrë si dëshmi të pranisë së popullsisë sllave në ato vende ose edhe si toponime të vëna prej popullsisë sllave me mbizotërim sllavësh, por më shumë si ndërhyrje të administratës të fesë etj.

Një krahasim i parë midis këtyre dy kadastrimeve na lejon të nxjerrim disa prej këtyre zëvendësimeve dhe përkthimeve, të cilat vlen edhe për raste të tjera e mund të japin shkas për gjurmime të mëtejshme për të parë mënyrat se si është ndërhyrë administrativisht në toponime. Ky krahasim vlen sepse na jep një pasqyrë të ndryshme të toponomastikës, madje edhe të antroponomastikës, nga ajo që është menduar deri më sot.

Defteri i vitit 1485 është në vetvete repertori antropo- dhe toponomastik më i gjerë i shek. XV për Sanxhakun e Shkodrës: përmban më shumë se 20000 antroponime dhe toponime. Ky Defter, i përpiluar në Shkodër është pregatitur nga nëpunësi i fiskut otoman, Mustafa Siraxhuddin dhe shkruesi Sulejman Abdullahu<sup>2</sup>.

Në parathënien e botimit të këtij Defteri, S. Pulaha vë re, me të drejtë, se shkruesi i tij, i cili ishte «prej robërve të liruar të vezir Mahmud Pashës, duhet të ketë qenë me kombësi sllave, sepse ai i vë zakonisht emrat në rasën gjindore të serbishtes, p.sh. *baştina der desti Dabjiva*, ose *baştina Ivko der desti Radosava*»<sup>3</sup>.

Po të shikojmë edhe para vitit 1485, gjurmët e kësaj tradite më të hershme shihen nganjëherë edhe në vetë Kadastrin e Shkodrës ose gjethë në defterë të tjerë të kohës osmane, sepse krahas përkthimeve italisht si *Pietra Negra* për *Gurizi*<sup>4</sup>, ose *Zabojana* për *Tebunë*, kemi edhe *Pietra Bianca* për *Guribardhë* në Mat. P.sh. ndërsa te harta e Gastaldit, rreth vitit 1560, kemi trajtën shqipe *Guri bar*<sup>5</sup>, në Defterin e vitit 1467 për Dibrën, ky *Guribardhë* bëhet *Bilakamin*<sup>6</sup>.

Burimet dhe faktorët e kësaj praktike, edhe në kohën e enklavës venetiane, shihen edhe te kadastrin e viteve 1416-17, sepse edhe aty kemi të shënuar në Koplik një Thoma Shkajau «shkrivan i oborrit në gjuhë sllavishte»<sup>7</sup>. Krahas këtij, ishte edhe përkthyesi i oborrit në gjuhën venet, Gjin Jubani (*Ghino Lubano trucimano curie*), ose po aty gjindë edhe Marin Bonci, që bën si dragoman për Hotët në një dokument të datës 26.III.1417<sup>8</sup>.

Nga ana tjetër, në Defterin e vitit 1485, shihet edhe ndonjë fillim turqizimesh, që është shumë i theksuar sidomos ndër emrat e qytetereve

2) *Defteri 1485* / fl. 209, (f. 49).

3) *Defteri 1485*, vëll. I, Hyrja, fq. 5.

4) *Acta Albaniae Veneta*, München 1970 (më tutje AAV), vëll. VIII, dok. 2158/3.

5) K. Ulqini, *Nga toponomastika e shek. XVII*, në «Kumtar i Muzeut popullor të Shkodrës», Shkodër 1973, 107.

6) S. Pulaha, *Burime osmane*, Tiranë 1968, 326.

7) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/18 e passim. Mbi këtë pikë do të kthehem në fund të artikullit.

8) AAV, vëll. VIII, dok. 2065 e 2150.

*Iskenderije* për Shkodër, ose *Altun-ili* për viset e Gjakovës, etj. Përkundrazi, në emrat e fshatrave, këto raste janë shumë të rralla në këtë kohë<sup>9</sup>.

Por, në qoftë se venetizimet nuk kanë pasur jetë të gjatë (mbasi hyjnë në natyrën e çdo regjistrimi të bërë nga të huaj), rastet e sllavizimeve vazhdojnë edhe pse ka kohë që është larguar sundimi sllav, e në ndonjë rast do të vazhdojnë edhe në defterin tjetër të bërë gati një shekull më vonë, më 1582. Këto provojnë se, megjithëse në Gropën e Shkodrës dhe në viset e tjera pushtimi sllav kishte pushuar tash sa kohë, ky shkruer i Defterit turk ndiqte traditën e sllavizimit administrativ të emrave, që shtyhet disa shekuj më parë, në kohën e pushtimit sllav të mirëfilltë. Kjo traditë do të shihet edhe në kadastrimet turke më vonë, si edhe në dokumente të tjera, por pa pasoja të mëdha për toponiminë e mirëfilltë shqiptare, këtë herë.

Pjesa e Sanxhakut të Shkodrës që po shqyrtojmë është kryesisht shtrirja e Komunës së Shkodrës, pa Drishtin, i cili përbënte një komunë më vete dhe duhet të kishte kadastër të vetin, që mjerisht nuk ka ardhur deri në ditët tona, dhe pa Zadrimën, që mungon edhe në Defterin e 1485-ës, sepse në atë kohë shkonte me Sanxhakun e Dukagjinit. Mjafton edhe kjo për t'i vënë në dukje disa nga ato ndërhyrje që mund të kapen, sepse krahasimi shtrihet prej liqenit të Hotit deri në Malet Mjet (Shëngjin). Shqyrtimi bëhet në rrjedhën kohore midis dy kadastrimeve, duke kërkuar ndonjë mbështetje ose vërtetim të mëtejshëm edhe në ndonjë dokument tjetër.

\*

1. Në Defterin e 1485-ës del një *Podol-Tuz* «timar i Hëzer Kestireliut»<sup>10</sup>, i cili, me elementin e parë nga fusha e orografisë, *podol* «lug, luginë», mund të merrej si një ngulim i ri midis dy kadastrimeve të Shkodrës. Ky dyshim shtohet edhe kur shohim se në këtë ndërkohë ka shumë fshatra që janë zhdukur fare dhe ka fshatra të tjerë që dalin rishtas, ndoshta edhe me emra të tjerë, ose ka edhe grumbullime fshatrash të kadastruar në një mënyrë tjetër dhe që nuk dallohen nga njëri regjistër te tjetri. Por, kur kemi parasysh se treva është plot me këso emërtimeve orografike, dhe se ky toponim del edhe gjetiu, atëhere mund të mendohet për një përkthim të thjeshtë. Kjo na lejon të gjurmojmë te kadastrin e parë për të parë me cilin toponim mund të lidhet.

Në Kadastrin e Komunës së Shkodrës 1416-17 gjindet një *Lugi*<sup>11</sup>, për të cilin është dhënë mendimi se lidhet me *Lujgjit e Koplikut*<sup>12</sup>. A. M. Selishçevi nuk merr qëndrim për vendin se ku gjendet por e lidh me serbishten *lug* «imshtë, pyll»<sup>13</sup>. E. Armao, duke folur për një hartë

<sup>9</sup>) Ndoshta do të hynte këtu ai *Kakariq-Duz* që Pulaha e jep ndër kllapa si «Kakarriqi fushor» (*Defteri 1485/fl. 129*), duke u nisur, me sa duket, nga turq. *düz* «vend dyst, shesh». Në na duket se në këtë rast duhej pasur parasysh homonimia imitative, me kalimin nga një gjuhë në një tjetër, sepse po aty kemi, më 1417 një *Tuzanj i vogël nën Shkallë (Tusanj pizolj soto la Scala)*, që me kalimin *t < d*, duhej të jepej më drejt Tuzi i Kakarriqit, sipas mendimit tonë.

<sup>10</sup>) *Defteri 1485/fl. 175*.

<sup>11</sup>) AAV, vëll. VIII, dok. 2076, 2104, 2107/b.

<sup>12</sup>) AAV, vëll. IX, s/v *Lujgji i Koplikut*.

<sup>13</sup>) A. M. Seliščev, *Slavjanskoe naselenje v Albanii*, Sofia 1932, 279..

të Coronellit të vitit 1688, ku shënohet *Lugi*, lidh me këtë *Lugi*-n e 1417-dhe e shpie në *Grykëlugje*, ndërmjet Ducajt dhe Bogës<sup>14</sup>. Cordignano është mëdyshas midis *Lugut të Egçit* dhe *Lujzave të Koplikut*<sup>15</sup>. Gelasius, për kundrazi, i hedh poshtë këto vendosje dhe e shpie këtë *Lugi* të Kadastrit 1416-17 në *Lug të Rrjollit*<sup>16</sup>.

Vendosja e saktë e *Lugut* ka rëndësi në qoftë se duam ta lidhim me *Podol-Tuzin* e Defterit. Tuzët, që ishin më parë njerëzit e Balshajve, nën ndeja e të cilëve duhej të ishte jo në Tuzin e sotëm<sup>17</sup>, siç është thënë sepse ky del jashtë kufijve të atëhershëm të Komunës së Shkodrës, por rreth Buzujës së sotme, kërkojnë koncesione pronash në Komunën e Shkodrës me të drejtë shërbimi në *ushtë* (*hostis*), dhe këto u jepen bashkë me disa privilegje për shërbimin ushtarak. Ndër të tjera u jepet edhe ky *Lugi*, që e shpjegon fare mirë gjymtyrën e dytë *Tuz* të fjalës *Podol* më 1485, dhe kështu del edhe përkthimi që i bën shkruesi gjymtyrës më parë me *Podol*, pse aty gjindet edhe sot *Lugu i Egçit të Bregut*, dhe vendosja provohet edhe prej kadastrimit turk të vitit 1485. Prandaj, vendosja e *Lujgjit e Koplikut* është gabim, dhe përkthimi me serbishten *podol* shkruesit të Defterit turk provon se e ka kuptuar më mirë vështrimin e fjalës shqipe *lug* se Selishçevi, i cili e lidh këtë me homonimin sllavisht *lug* «imshtë, pyll», pa marrë parasysh se ky term i fushës së orografisë është prodhimtar në mbarë toponomastikën shqipe.

Po ta vazhdojmë gjurmimin dhe ta kërkojmë fjalën *Podol* në toponomastikën e sotme ose edhe në atë historike, vëmë re se Tuzët, kur më 1416-17 kërkojnë koncesione pronash në Komunën e Shkodrës, nuk e përdorin asnjëherë ata vetë fjalën *Podol* në tre dokumentet që përpilohen për feshatën e tyre (5 raste)<sup>18</sup>, sepse kështu njihet vendi. Nga ana tjetër, kur kemi parasysh se gjymtyra e dytë e këtij toponimi na del edhe për disa fshatra

14) E. Armao, *Località, chiese, fiumi, monti e toponimi varii di una antica cartina dell' Albania settentrionale*, Roma 1933, 79.

15) F. Cordignano, *Registrum Concessionum*, Roma 1942, 174.

16) Gelasius, në recensionin e E. Armaos, në «Hylli i Dritës» 1938, 202. Ai thotë se aty gjendeshin edhe «dzyzetekatër mullinj e valanica» (dërstila), në një kohë që, siç shihet nga këto dy kadastrime, vendi duhet të ketë pasur një veshje bimore më të dendur, dhe dy lumenjt e atëhershëm, *Riola* dhe *Slicca* (Sheu i Rrjollit dhe Prroni i Ziçës) kishin ujra më të shumtë. Formacione karstike të kësaj treve duket se nuk i kishin ndryshuar ende në rryma të ndryshme një pjesë të këtyre ujrave (shih AAV, vëll. VIII, dok. 2107/61).

17) I pari që e sheh në dokumentet turke këtë identifikim është B. Djurdjev (në *istorije Crne Gore, Brdskih i Malisorkih Plemena*, «Radovi naučnog društva BiH-Sarajevo 1954, shën. 24). Ky citon Defterin e përmbledhur turk të vitit 1494 «Nahija e Hotit që ka gjashtë fshatra, le të mbajë të gjitha derbendet që shtrihen prej fshatrave që njihen me emrin Tuz i Poshtëm deri tek fshatrat që njihen me emrin Tuz i Sipërm, në rrugën që shkon prej Kështjellës së Shkodrës deri në Kështjellën e Depedukanit dhe të Medunit», *Tuzin e sipërm*, e vendos prandaj, në veri të Hotit, dhe në fakt në Defterin tonë ky shkon me Zhabjak (fl. 164), ndërsa *Tuzi i Poshtëm*, që del në Kadastrin e vitit 1416-17, me emrin *I Tuzj*, hyn në shtrirjen e Komunës së Shkodrës. Ne prandaj duhet ta vendosim rreth Buzujës, siç e kemi rrjeshtimin në këtë kadastrë ndërmjet *Kaldrunit*, *Osetit* dhe *Koplikut* (shih AAV, vëll. VIII, dok. 2107/12-18). Duhet theksuar këtu edhe se *Oseti*, nuk lidhet me *Rosekun*, si mendon Pulaha (fl. 171), por me *Kodrati Moksetit*, sepse *Roseku* është edhe sot fshat në Postripë, pra larg Koplikut.

18) AAV, vëll. VIII, dok. 2076, 2104, 2107/b.

të tjerë që janë në Kadastrin e Komunës dhe që tregojnë shtrirjen e pronave të Tuzëve, shohim edhe më mirë se shkruesi i defterit ka bërë një përkthim të thjeshtë të fjalës shqipe.

Duket se prej këndej, ky toponim *Podol* ka vazhduar edhe për disa kohë në aktet fiskale të administratës turke në Shqipëri, sepse afro një shekull më vonë, në Defterin e Shkodrës të vitit 1582<sup>19</sup>, do të gjendet përsëri kjo trajtë *Podol-Tuz*. Megjithatë, pavarësisht si mund ta quante vendbanimin administrata osmane në atë kohë, në aktet zyrtare, popullsia vazhdonte të përdorte emërtimin e vet, sepse, ashtu si më 1417, si e pamë më sipër, po edhe më 1614 te Bolizza<sup>20</sup>, dmth jo shumë pas defterit të dytë turk, edhe më 1688 te Coronelli<sup>21</sup> e gjetiu, do të kemi kurdoherë *Lugi*. Këtij apelativi *Podol* nuk do t'i gjindet asnjë gjurmë në Mbishkodër, as në mikrotoponimi, me sa kam kontrolluar unë.

Kjo tregon, nga ana tjetër, se ky emërtim sllavisht i Sulejman Abdu-lahut ka kaluar nga defteri në defter deri më 1582, pastaj humbasin gjurmët e tij, siç humbet edhe pjesa e dytë e emërtimit Tuz, që shënonte dikur pronarët, duke mbetur vetëm emërtimi vendas: *Lugu i Egçit të Bre-gut* deri në ditët tona<sup>22</sup>.

2. Një tjetër emër vendi që tërheq vëmendjen më 1485 është ai i fshatit *Shkripol*<sup>23</sup>. Botuesi i Defterit, S. Pulaha, e shënon në hartën e tij si fshat më vete: një *Shkrel* dhe një *Shkripol*, afër njëri tjetrit<sup>24</sup>. Përkundrazi, një shqyrtim i imtë tregon se ky *Shkripol* është i ndarë në tri pjesë, pse në krye të regjistrimit të fshatit kemi këtë shënim: «një të tretën e fshatit e zotëron Hëzeri, kurse dy të tjerat i zotërojnë të tjerë»<sup>25</sup>. Nga ana tjetër, më 1417 nuk del një *Shkripol* dhe as nuk i gjinden gjurmë ndonjë *Shkripoli* tjetër në Defterin e 1485-ës, që t'i plotësonte me këtë emër dy pjesët e tjera. Sidoqoftë, duke parë se pjesa e Hëzerit është këtu, dy pjesët e tjera duhet të gjenden natyrisht po në këtë Defter, qoftë edhe me një emërtim tjetër.

*Shkripoli* i Defterit numëron 57 shtëpi dhe 17 beqarë, dmth përbëhet nga 73 zjarre<sup>26</sup>. Po në këtë Defter kemi një *Ishkril* me 24 zjarre dhe një *Shkril* me po 24 zjarre<sup>27</sup>. Po t'i zbresim këto 48 zjarre nga 73 zjarret e *Shkripolit*, na mbetën 25 zjarre o shtëpi, dmth vërtetohet një e treta që i përkiste timarli Hëzerit, dhe dy të tretat e tjera (24 + 24 zjarre) janë ato që i «zotërojnë të tjerët» dmth Gazi Shuxhahu dhe Vukosavi.

19) S. Pulaha, *Ngulja e katuneve dhe krijimi i fiseve në Shqipërinë e Veriut në shekujt XV-XVI* në «Studime historike» 1(1975) në shtyp.

20) I. Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII*, vëll. I, dok. 3/176, f. 260.

21) E. Armao, *vep. cit.* harta.

22) Po ta shtyjmë vështrimin në një sferë që kapërcen shtrirjen e Komunës së Shkodrës, por që kurdoherë është lidhur me të, në Pult kemi një *Dola* «fshat i braktisur» (*Defteri 1485/fl.* 240), që nuk është tjetër, edhe ky, veçse *Lugu i Pul-tit*, si e gjejmë te Bolizza dhe e kemi edhe sot (I. Zamputi, *Relacione I*, 3/171v).

23) *Defteri 1485/fl.* 185.

24) *Defteri 1485*, vëll. I, harta.

25) *Defteri 1485/fl.* 125.

26) *Defteri 1485/fl.* 142.

27) *Defteri 1485/fl.* 129.

Kemi edhe një vërtetim tjetër që e përforcon edhe më mirë sa thamë më sipër. Po të shikojmë ndarjen e të ardhurave të fshatit, timarlivë. Hëzer merr në Shkripol 2000 akçe nga 6000 akçe që jepte gjithsej fshati. Po këtu shënohet se «pjesa e të tjerëve është 4000 akçe»<sup>28</sup>. Teprica, dmth 4000 akçet e tjera ndahen në pjesën që merr Gazi Shuxhahu si *Ishkril* (2000 akçe) dhe në *Shkril* pjesa e Vukosavit, birit të Gjurashit, është po 2000 akçe<sup>29</sup>. Kështu ndarja është e njëjtë si akçe dhe si shtëpi ndërmjet tre timarlive.

Dy provat plotësojnë njëra tjetrën dhe vërtetojnë se kemi të bëjmë me të njëjtin vend, *Shkrelin*, i cili më 1417 del vetëm si *Schirelli*<sup>30</sup>. Në këtë kadastër nuk ka, si e thamë më sipër, një *Shkripol*. *i*-ja nistore të *Ishkril* është një shtesë tipike e turqishtes, dhe kalimi *e* < *i* në trup të fjalës mund të jetë ndonjë luhajtje e kohës (për leximin në Defter Pula-ha u vë nga një asterisk, dmth leximet janë të sigurta). Kur krahasojmë po në këtë kadastër të komunës onomastikën, edhe këtu shihet një farë luhajtje, sepse na dalin trajtat *Screlli*, *Scherelli*, *Schirelli*<sup>31</sup>, e njëkohësisht edhe në vetë Defterin e vitit 1485 gjenden trajtat patronimike *Shkreli*, *Shkrili*<sup>32</sup>, por nuk del asnjë patronim me *Shkripol*, sipas ligjit të huazimeve toponim/patronim. Edhe kjo vërteton se ky toponim *Shkripol* është një diçka e re që mbetet në Defter.

Kështu, për mendimin tonë, provohet edhe një herë ndërhyrja e drejtpërdrejtë e shkruarit të Defterit turk, i cili krijon një toponim *Shkri(l)pol* të paqenë, duke formuar një emërtim të përbërë me shtimin e një *-pol*, si shkurtim të fjalës sllave *polje* «fushë».

Ky *Shkrel* i 1417-ës dhe *Shkril-Shkripol* i 1485-ës duhet të jetë vetë *Zagora* e sotme, vendbanimi më i madh i Shkrelit, që quhej *Shkrel* në atë kohë, para se ky emërtim të përhapej dhe të bëhej emri i mbarë një treve, siç e kemi edhe sot, sepse sot nuk kemi një fshat të mirëfilltë të emërtuar *Shkrel*, por krejt një trevë. Se edhe ky emërtim *Zagorë* është më i ri, e vërteton tërthorazi vetë Kadastri i Komunës, sepse nuk kemi *Zagorë* më 1417, as në Defterin e vitit 1485, as te Bolizza më 1614, as te Gergj Bardhi më 1634, as te Shtjefën Gaspri më 1680, por vetëm te harta e Coronellit më 1688 do të gjejmë trajtën *Sogoru*<sup>33</sup>. Prandaj ky viti 1688 ndoshta mund të merret si një *terminus ante quem* për daljen në atë kohë të këtij toponimi *Zagorë*, të cilin unë nuk e kam ndeshur më herët. Po që kështu, atëhere edhe dy shekuj pas pushtimit turk gjenden gjurmë emërtimi me emra sllavë. Dhe se po kjo dukuri është edhe në vende të tjera, siç e pamë më sipër me *Guri Bar* < *Pietra Bianca* < *Bilakamin*. Por këtë herë, *Zagorës* i mbeti ky emër në dëm të emrit të vjetër, siç kanë mbetur edhe shumë emra të tjerë.

Nga ana tjetër, këtij *Shkripoli* nuk i kanë mbetur gjurmë, me sa kam kontrolluar unë, as në dokumentet e tjera të relatorëve të shek. XVII, as në mikrotoponiminë e këtyre viseve. Edhe në qoftë se del në dokumente të tjera turke, nuk mund të jetë veçse një gjurmë e administratës, një

28) *Defteri 1485/fl. 126.*

29) *Defteri 1485/fl. 142 e 129.*

30) *AAV, vëll. VIII, dok. 2107/36.*

31) *AAV, vëll. VIII, dok. 2107/11, 36, 44 dhe 2158/76, 80.*

32) *Defteri 1485/fl. 172, 174.*

33) E. Armao, *vep. cit.*, s/v *Zagoraj* dhe harta.

kalim nga defteri në defter, si e pamë më sipër për *Podol*, por pa pasoja në toponiminë e këtij vendi, sepse të paktën qysh më 1417 e deri më sot kemi emërtimin *Shkrel*.

3. *Istulush-Tuz* është një emër tjetër, leximin e të cilit Pulaha nuk e jep të sigurtë<sup>34</sup>. Prof. E. Çabej më sugjeron se mund të lexohet edhe *Istolosh-Tuz*. Pra, duke i hequr *i*-në nistore turke kemi *Stulush* ose *Stolosh* ose *Stolush*.

Kur kërkojmë në Kadastrin e 1416-17-ës, shohim se Tuzët marrin, si oligarki feudale, disa fshatra nga Komuna e Shkodrës, dhe të gjitha këto fshatra na dalin më 1485 me mbiemrin *Tuz: Damniç-Tuz, Gjon-Tuz, Pistull-Tuz, Petrashani-Tuz*, etj. Të gjithë hyjnë në *Tuzin e poshtëm*, siç e pamë më sipër (shih shën. 17). Pikërisht në këtë shtrirje të Tuzëve si pronarë duhet të kërkohet edhe ajo që përfaqëson ky *Stulush* o *Stolosh* 67 vjet më parë, kohë që shkon prej vitit 1417, kur merret koncesioni, deri më 1485, kur bëhet kadastrimi osman. Në aktin e koncesionit këta marrin gati 3600 hektarë (*campi circa mille*) të vendit «të quajtur *Stoici*, një pjesë ara, një pjesë pyje»<sup>35</sup>. Këtu duhet kërkuar prandaj ky *Istulush-Tuz* o *Istolosh*, që nuk mund të lidhet me tjetër veçse me këtë *Stoici* të vitit 1417.

Autorë të ndryshëm që janë marrë me Kadastrin e Shkodrës nuk e caktojnë vendosjen e *Stoici*-t. A. M. Selishçevi, që i grumbullon emrat sllavë të Kadastrit, nuk e shpjegon këtë *Stoici* me sllavishten, megjithëse e përmend<sup>36</sup>. Te AAV (vëll. IX) shënohet vetëm *Stoici* dhe nuk bëhet përpjekje ubikacioni. Cordignano një herë e vendos në *Stajice*, mbi Çezmen e Koplikut, por pastaj thotë se ka më shumë mundësi të jetë në tokat e quajtura *Shtojza*<sup>37</sup>, nën rrugë që të çon te Çezmja e Koplikut tej Sheut të Rrjollit.

Si rrjeshëm fshatrash më 1417, vjen ndërmjet Gradecit, Virit dhe Kamnicës, prandaj ka më shumë mundësi të jetë ndërmjet fshatrave Kamnicë dhe Pjetrashan. Një provë tjetër se është në atë rreth e kemi edhe te Defteri i 1485-ës, ku *Istulush* o *Istolosh* është shënuar mbi *Pjetrashani-Tuz*, dhe është një timar me të<sup>38</sup>. Prandaj vendi duhet identifikuar në shtrirjen para Kamnicës, rreth fshatit të sotëm Flakë, kufi me Pjetrashanin, në *Shtojza* ose *Shtojca*, që jep edhe gjurmën e vjetër të këtij emri, jo gjetkë.

*Stoici-Stolosh-Shtojcë(-zë)-Shtoj* lidhet me dokumentacionin e kohës si ubikacion. Pavarësisht prej regjistrimit të emrit të parë sipas fonetikës italiane dhe pikënisjes së shkruarit të Defterit turk, ndoshta nga një *Stol*, vetë apelativi *Shtojcë-Shtoj* (*Stoici* në trajtën e venetizuar) duhet të lidhet, po t'i përmbahemi dokumentacionit të kohës, me termin teknik feudal të rezervës së senjorit ose të senjorisë<sup>39</sup>, sepse përbëhet nga «ara,

34) Defteri 1485/fl. 383.

35) AAV, vëll. VIII, dok. 2076.

36) A. M. Selišev, *vep. cit.*, 85.

37) *Registrum Concessionum*, 156, P. Daka regjistron *Shtojca* në Koplikun e Poshtëm (shih Ark. Topon. i Sekt. Leksikologjisë në Inst. e Gjuh.-Letërs. s/v *Koplik i Poshtëm*).

38) Defteri 1485/fl. 348. Pulaha nuk e vendos në hartën e bashkangjitur.

39) Gjurmët e rezervës së senjorit feudal i kemi edhe në mikrotoponiminë e vendit tonë. Po përmendim dy shembuj: *Suka e Shenjorit* në Koplik dhe *Çezma e Shenjorit* në Hekal të Mallakastrës. Për përhapjen e emrit të vendit *Shtoj* në viset e Shqipërisë Verilindore po përmendim: *Fusha e Shtojit* e *Shtoj i Ri* (Shkodër), *Shtoji i Ulqinit* (Ulqin), *Gropa e Shtojit*, (Koplik i Sirmë), *Shtojza* (Ara në Grizhë), *Shtoji i Vucae* (Kokëpapaj — Gruemirë), etj.

livadhe, pyje» të cilat jepën në koncesion drejtpërdrejt pa ndërmjetësi dhe pa zëvendësim, dhe vetë shtrirja tregon se është sipërfaqe e gjerë.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se, megjithëse ky *Stulush-Stolosh* do të na dalë përsëri në Defterin e dytë turk më 1582, nuk do ta ndeshim më 32 vjet më vonë te Bolizza më 1614, dhe as do të shënohet rreth në shekull më vonë te Harta e Coronellit më 1688. Emri do të dalë në këtë trajtë si *Istulush-Istolosh* nga defteri në defter deri më 1582, por vendosja e kësaj sit do të vazhdojnë t'i quajnë këto pika me *Shtojcë-Shtojzë-Shtoj*.

4. Lohja, më 1417 *Lochoy* dhe *Logoa* si antroponim dhe si emër të vendit<sup>40</sup>, kishte në atë kohë rangun e kryevendit, sepse kishte nën vepër edhe pjesë të Rrjollit (ndërsa pjesa tjetër shkante nën Bolc), pra kishte një zhvillim të vetin, ndoshta si vendosje jo aty ku gjendet sot, por rreth e qark këtij vendbanimi ose në afërsi të tij. Dihet se krerët (*cavi*) janë mbajtës parasporesh, kanë vreshta dhe koncesione të tjera, përjashtohet prej tatimesh dhe ngarkohen prej komunës për mbledhjen e tatimeve fshatarëve. Pra marrëdhënie feudale të pandërmjetuara, dhe krerët, mbajtës të komunës ata vetë, nuk janë në vartësi të proniarëve.

Po ta marrim fjalën *log* «lëndinë e vogël; shesh, mejdan», së pari shkon mendja te serbishtja *log* «shtrofkë». Por fjala shqipe duhet të jetë e një gurre tjetër, pse si *Lohe*, që lidhet më shumë me atë *Lochoy* që shënon shkruesi venedikas, e kemi edhe te Sh. Gasprit *Loeia*<sup>41</sup>, dhe si *Lohe* (pra *Loh[ë]ja*) te harta e Coronellit<sup>42</sup>, dhe kështu vjen deri në ditët tona si *Lohe-Lohja*. Prandaj *Logoa* mund të jetë një kontaminim sipas shqiptimit sllav.

Në Defterin 1485, kjo *Lohe* del si *Luk*: «Fshati Luk (Lok), varet nga Shkodra»<sup>43</sup>. Kjo shkon me Shkodër, dhe shënimi i shkruesit nuk lë asnjë dyshim, prandaj duhet identifikuar me Lohen e sotme. Por, nga ana tjetër, kemi edhe një *Luk* tjetër, që nuk lidhet me komunën e Shkodrës por shkon me Drisht: «Fshati *Luk (Lok)*, varet nga Drishti, timar i Hëzerit, vepër llajt të Iliazit, i braktisur dhe i shkatërruar»<sup>44</sup>. Kësaj *Lohe* të Drishtit nuk i gjinden gjurmë në makrotoponiminë e sotme, dhe natyrisht, si pjesë e komunës tjetër të Drishtit, nuk flitet për të më 1417. Braktisja e shkatërrimi duket se e kanë bërë punën e vet.

Edhe në qoftë se i drejtohem makro- dhe mikrotoponimisë së këtyre viseve, nuk gjejmë asnjë rast me *Luk* ose me *Lok*, por gjithmonë me *-h-*, dhe ka mjaft mikrotoponime të tilla gjithandej.

Duke i pasur të gjitha këto parasysh ky kalim i shkruesit të defterit në *-k-* ka të ngjarë të jetë një kontaminim me s. *-kr. luk* «qepë; presë hudhër»; që janë edhe kulturat e specializuara të këtij rrethi.

5. Truallishta<sup>45</sup> *Bjeli Brod* shënohet në Defterin e 1485-ës, pas Lepuroshit dhe hyn në timarin e përbashkët të Jusuf Zerdit, Sulejman

40) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/40 e 58.

41) Relacioni i Sh. Gasprit, *Një dorëshkrim i vitit 1671 mbi Shqipni*, «Hylli i Drishtës» 1930, 605.

42) E. Armao, *vep. cit.*, harta (mbi Rrepisht).

43) *Defteri 1485/fl.* 32.

44) *Defteri 1485/fl.* 126.

45) Ndoshta ishte dashur që Pulaha të përkthente më mirë «troje» se «truallishta».

Matjes, Iljaz Vardarit dhe Selim Muezinit. Është një vend trojesh, si e thotë vetë Defteri, dmth i lënë ose i braktisur, që punohet nga të jashtmit dhe që jep të ardhura 400 akçe në vit<sup>46</sup>.

Po të nisemi nga apelativi sllav *brod* «va, vah», do të ishte shumë vështirë të dallohej se ku mund të ndodhej ky vend ose të njohim lidhjen e apelativit me relievin që i jep edhe arsyen e qenies së tij, sepse treva karstike me rrjedhat e pakta ujore të sotme nuk japin dorë për të parë se ku mund të ishte vendosur një *Vau i Bardhë*, që do të ishte përkthimi i shqip i *Bjeli Brod*. Vetë fjala *va-u* nuk del veçse në ndonjë rast të rrallë, në mos të vetëm në këto vise.

Përkundrazi, në qoftë se kemi vetëm ndonjë rast sporadik të *vaut*, gjejmë shpesh toponiminë *Bardhulinë*, që do të shpjegonte gjymtyrën tjetër të këtij toponimi dhe arsyen e qenies së tij, sepse formacionet podzolike të lbardha ose të hinjta janë të shpeshta në Gruemirë, Grizhë, Koplik, Buzujë, Linaj, dhe gjetkë<sup>47</sup>.

Duke e marrë vështrimin e këtij emërtimi në pikëpamje të gjeografisë fizike, ose më mirë gjeomorfologjike, ndoshta mund të mendohet se dy «lumenjt» e shekullit XV (*Riola* dhe *Slicza*), që i përmendëm më sipër (shën. 16), me ujra të shumtë, me mullinj dhe dërstila në atë kohë, të kenë pasur nevojë për ndonjë ose disa vahe për kalim. Por, edhe kjo është të shtyesh shumë larg me hipoteza. Ndoshta këtu duhet pasur parasysh më fort niveli i vetë liqenit, që ishte më i ultë, siç na e dëshmon më qartë ndoshta harta e Coronellit më 1688<sup>48</sup>. Kjo vërtetohet, për shkak të XV-XVI, edhe të Barleti<sup>49</sup>, që flet për ishuj me manastire në liqen, e madje, edhe pse tërthorazi, edhe të vetë Defteri i vitit 1485<sup>50</sup>.

Një vërtetim tjetër, që lidhet më për së afërmi me çështjen që po shqyrtojmë, është edhe të harta e Coronellit. Liqeni i Hotit paraqitet aty si pellg krejt më vete, i lidhur me anën e një rrjedhe ujore me liqenin e Shkodrës. Në afërsi të këtij vendi ruhet edhe kujtimi i një *vaut*: *Rruga e Vaut*, emër arash, ku sot nuk ka as rrugë as va, dhe nuk ka shteg dalje, sepse përpara del laguna e Hotit<sup>51</sup>. Kjo duhet të tregojë, për mendimin tonë, se në këtë lagunë ose liqen të Hotit duhet të ketë pasur një va që lejonte kalimin në kënnallin që e lidhte atë me liqenin e Shkodrës.

46) *Defteri* 1485/fl. 170.

47) P. sh. *Bardhulinë*, ara në Grizhë; *Bardhulinë*, ara në Koplik, etj. P. Daka e shpjegon termin në Toponomastikën e tij: «brumi i tokës është pak si i lbardhë», dmth kemi të bëjmë me një formacion aluvionesh podzolike me xhveshje të shkëmbit-amë.

48) Harta e Coronellit na e paraqet Liqenin e Shkodrës si një pellg me tre ishuj të mëdhenj, dy para viseve të Krajës dhe Shestanit, dhe një tjetër para Rjekës së Malit të Zi (*Crnojevička Rijeka*). Se niveli i liqenit ngrihet vazhdimisht, këtë e vërtetojnë edhe punimet hidrografike të bëra qysh nga fundi i shekullit të kaluar, dhe sidomos punimet e bëra gjatë këtyre vjetëve të fundit.

49) Marin Barleti (*De obsidione Scodrensi*, në përk. e H. Lacës, *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë 1967, 38) e thekson këtë ngritje të ujrave të liqenit.

50) Defteri i vitit 1485 flet për dy manastire në dy ishujt e Krajës dhe Shestanit që hynin në Sanxhakun e Shkodrës: «Manastiri Viranja brenda në ishullin e Liqenit të Shkodrës. Është famulli. Shtëpi 2»; «Manastiri Istarxhik Gorica. Varet nga e sipërpërmendura (Shkodra). Ndodhet në ishull. Shtëpi 1». (*Defteri* 1485/fl. 210).

51) Sh. toponimet e P. Dakës s/v *Buzujë*. Duhet theksuar këtu se vjeljet e P. Dakës, mbi të cilat jemi mbështetur kryesisht për mikropotoniminë, janë bërë me shumë kujdes, duke dhënë shpesh herë edhe hollësira mbi vendin.

Ka të ngjarë prandaj që në atë kohë ose edhe në një kohë të mëvonshme të ketë pasur këtu një va, që do të përlligjte edhe arsyen e qenies së toponimit. *Bjeli Brod* hyn në atë timar ku është edhe fshati *Zhajna* dhe këtë Pulaha e lidh me *Xagneva* të 1417-ës<sup>53</sup>. Në ato vise e kemi shpesh të gjymtyrën tjetër të këtij toponimi, *Bardhulinë*, siç e vumë re sipër, dhe në ato afërsi edhe *Rrugën e Vaut*, pa rrugë e pa va sot. Si ubikacion mund të jetë prandaj në afërsi të *Zhajnës*, ndoshta të *Jeranit* të këtyre tëm që shkon me *Buzujë*. Por, pavarësisht prej vendosjes së saktë të këtyre trojeve të 1485-ës, përkthimi *Bjeli Brod* < *Varbardhi* ose *Vau i Bardhi* nuk do komente.

6. Emri tjetër mbi të cilin do të ndalemi është ai i *Bishtrrjollit*. Deferi e dyzon me *Barsh*: «Fshati *Bisht Rjola*, emri tjetër *Barsh*, varet në Shkodra»<sup>54</sup>. Mund të mendohet, nga një anë, se ky emri i dytë i po kësaj njëjtiti fshat, është ndonjë aso raste dyzimesh që paraqet toponimia. Por duke mos i gjetur gjurmë në mikrotoponiminë e *Bishtrrjollit* (dhe duket të linte këtu ndonjë gjurmë po të ishte emër popullor, siç i ka lënë vërtet *Bishtrrjollin*), ka pak të ngjarë të ketë qenë emër i përdorur aty. Kur kemi mi parasysh sllavizimet e tjera, atëhere vjen edhe pyetja pse e dyzoi ky emër shkruesi i Deferit, kur në Kadastrin e Komunës së Shkodrës të 1416-17 kemi vetëm *Bistiriola*<sup>55</sup>, dmth *Bishtrrjolla*, pa e përcjellur ndonjë emër tjetër si në raste të tjera<sup>56</sup>?

*Bishtrrjollin* gjendet buzë liqenit të Shkodrës, aty ku Sheu i *Rrjollit* derdhet në të, dhe kjo i jep edhe arsyen e emrit të tij. Mundet që në emrin e dytë *Barsh* shkruesi i defterit të ketë përkthyer ndonjë toponim shqip duke vënë në bazë s.-kr. *bar* «mel», që në atë kohë ishte kultur kryesore në tokat e varfëra të këtyre viseve, para se të përhapej kultura e misrit. Po të nisemi nga *mel*, vendi jep disa *Melishte*, e ky mikrotoponim gjindet edhe në shumë vise të Shqipërisë, si dëshmi e kësaj kulture të përhapur në një kohë. Vetë *Bishtrrjollin* paguante në atë kohë «dhjetën e melit» (*la diesma del mio*) shtëpi për shtëpi, dhe mua më duket se kështu mund të gjejë shpjegim toponimi *Barsh*, që pamë më sipër.

7. Në Deferin e 1485-ës del edhe toponimi *Balvezi*<sup>57</sup>. Në shpjegime që jepen aty mbi detyrimet feudale, *Balvezi* kishte «vreshta dhe dajlanë hasa»<sup>58</sup>. Vreshtat gjinden gjithandej në këtë trevë, dhe janë, bashkë me ullishtat, kryesisht element komunal, ndërsa dajlanet na tregojnë shprehimisht se vendi duhet të kërkohet buzë liqenit dhe jo gjetkë. Këto dajlane na vlejné pikërisht për ubikacionin dhe na lejojnë ta identifikojmë me *Ballézën* e Grizhës, që nuk duhet ngatërruar me *Balëxën* ose *Balecën*.

52) *Defteri 1485/fl. 169.*

53) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/32.

54) *Defteri 1485/fl. 156.*

55) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/9.

56) Ambigjeninë e këtij emri e tregojnë edhe sot dy trajtat *Bishtrrjollin* dhe *Bishtrrjolla*, sidomos në disa rasa të lakimit fillon trajta femërore.

57) *Defteri 1485/fl. 347.*

58) *Po aty.*

si përdoret sot në literaturë<sup>59</sup>. Ka mjaft mundësi, duke pasur parasysh analogjinë e emrit, të jetë një ngulim i vonë në atë kohë i disa banorëve të qytetit ose të rretheve të Balëxës së sipërme të shkatërruar, sepse më 1417 përmendet përsëri si qytet, ndërsa më 1485 do të jetë fshat. Përkundrazi, pikërisht në këtë ndërkohë, prej kadastrit të parë tek i dyti, na del ngulimi i ri nën emrin *Balvez*, me 11 zjarre, po në breg të liqenit të këtu herë.

Ndoshta kështu merr kuptim ajo gojëdhëna që përmend Gelasius<sup>60</sup>, ose Lekë Viti e Dodë Viti kishin lënë Balëxën dhe kishin ndërtuar dy kulla nën Qetë të Vitaj. Në fakt, Vitejt ishin kryengritës (*reulli*) kundër sundimit venedikas, por kujtimi i tyre ka mbetur<sup>61</sup>. Në Kokëpapaj kemi edhe sot toponimet: *Qeta e Vitae* «shkëmb», *Maja e Qetës Vitae* «shkëmb i lartë», *Buni i Qetës Vitae* «kullotë»<sup>62</sup>, që ruajnë, bashkë me gojëdhënën, kujtimin e shpërndarjes së vendasve të Balëxës.

Të gjitha këto elemente, prandaj, e përcaktojnë mirë vendin e Balvezit të 1845-ës në Ballézën. Edhe ky vendbanim i ri i balëxorëve të sipërm u zhduk para dy shekujsh, sipas gojëdhënës, këtë herë prej kolere ose prej murtaje<sup>63</sup>.

Shkruesi turk e sllavizon temën e fjalës, nga *Balléza* e bën *Balvez*, ndoshta me një kontaminim të fjalës shqipe, ose ndoshta duke u nisur nga s.-kr. *balvan* «shqeme, Rhus coriaria», si vend shqemeje.

Trojet e Balvezit ose të Ballézës gjinden te livadhet e Grudëkeqes, nën Linaj, por afër Egçit të Bregut.

8. Truallishta *Radina* «e braktisur» del për herë të parë më 1485<sup>64</sup>, dhe në Defter shënohet se «është tokë mbjelljeje» për fshatin Rash, që duhet të lidhet me *Rrashkullajn* e sotëm. *Rrashkullaj* shkon sot si lagje e Gruemirës, me rregullimin administrativ të pasçlirimit, dhe bën pjesë në kooperativën e bashkuar të saj.

Vendosja e saktë e saj si vendbanim ose si troje do një shqyrtim të shtetë në krahasim me Kadastrin e viteve 1416-17. Mikrotoponimia e *Rrashkullajt* të sotëm nuk na jep asgjë lidhur me këtë, dhe duket se ky fshati i fundit ka pasur ndonjë lëvizje, ose ndoshta nuk ka ruajtur asnjë gjurmë që të kujtonte *Radinën* e vjetër. Nga ana tjetër, duket se me kohë

59) *Balëxa* i thotë populli, jo *Balec*. Më 1417 quhet italisht *Cità de Balezo* (AAV, dok. 2107/48). Fan S. Noli (*Historia e Skënderbeut*, Tiranë 1962, 53), na thotë se ky qytet u shkatërrua prej serbësh, pas luftës së Dejës. Ai shton se ushtritë shqiptare marrin *Balëxën* (Noli e quan gabimisht *Ballsh*) dhe fillojnë ta rindërtojnë. Por, *Balëxa*, megjithëse me emrin qytet, ishte mjaft e kufizuar edhe më 1417, pavarësisht se për qytetet kadastrat flasin pak e aspak. Më 1688 te Harta e Coronellit shënohet: «*Balëxa*, dikur qytet» (*Balesa già città*). Më 1485 i ka humbur të gjitha e ka rënë në rangun e fshatit me 4 zjarre (*Defteri 1485/fl. 130*), nuk ka as rangun e kryevendit që kishte më 1417, më 9 fshatra nën vete, e edhe katër prej këtyre fshatrave janë shkatërruar, ndonjë tjetër është edhe zhdukur fare. Këtë kuadër e plotëson Sulejman Abdullahu duke i ndryshuar edhe emrin e duke e quajtur «Fshati Baren, emri tjetër *Balec*, varet nga Shkodra, timar i Hamzajt nga Seleniku» (po aty).

60) Gelasius, art. cit., 318.

61) AAV, dok. 2045/5-173 passim, 2061-2, etj.

62) P. Daka, *Topon.*, s/v *Gruemira*.

63) Gelasius, po aty; P. Daka, po aty.

64) *Defteri 1485/fl. 69*.

këto troje ju aneksuan Gruemirës, pse në Gruemirë ruhet kujtimi i dy palë trojeve-fshate të braktisura: *Redin* dhe *Dedshoçaj*<sup>65</sup>, dhe në fakt ajo pjesë e Gruemirës që vjen në këtë krah quhet *Gruemirë-Redi* ose *Redin*.

Çfarë mund t'i përgjigjet kësaj *Radine* të 1485-ës, në Kadastrin e Komunës më 1417? Në këtë kadastrë figuron një *Domini overo Naureda* (*Domni* ose *Naureda*)<sup>66</sup>, që gjindet nën qytetin e *Balëxës*. Te AAV shënohet *Nanreda*<sup>67</sup> në indeks, por vetë kadastrë ka *Naureda*. Cordignano thotë se quhet edhe *Nanreda e Ktoshit* (lagje e Grizhës)<sup>68</sup>. Gelasius e vendos, përkundrazi, në *Nauredë*, në breg të liqenit, si troje të lëna<sup>69</sup>, dhe me këtë ka parasysh *Naureden* ose *Redinin* e *Gruemirës* ku është *Naureda*. Vendosja është e drejtë, sepse më 1485 *Radina* shkon në një timar me *Rash*, siç e vumë re më sipër. Por, çuditet njeriu kur qoftë AAV, qoftë Cordignano, qoftë Gelasius, dyzimin e këtij: *Domini*, e shpien në *Domnin* e sotëm, mbasi *Domni* i mirëfilltë, ai që kemi sot, nuk del në kadastrin e vitit 1416-17, sepse shkonte me Komunën e Drishtit, jo me atë të Shkodrës, dhe për Drishtin nuk kemi kadastrë të kohës venedike. Vetë dyzimi *Domini* ose *Naureda* tregon se është një fshat dhe nuk ka pse të ndahet emri me dy ubikacione. Se *Domni* i sotëm shkonte edhe atëhere me Drisht e provon Defteri i 1485-ës; «Fshati Dom varet nga Drishti»<sup>70</sup>, ashtu si shkon edhe sot etnografikisht me Postripë, e cila hyn e gjitha në Drisht<sup>71</sup>.

Atëhere si mund të shpjegohet kjo mospërputhje? Ne mendojmë se ky *Domën* në *Balëxë* është shkukur që andej, dhe ka ardhë e është ngulur këtu në *Redi*. Gjurmët e tij gjinden edhe në mikrotoponimi, si *Kodra e Domçit* në Kokëpapaj (Gruemirë), *Domnat*, livadhe në Gruemirë, e mjaft emra arash, tokash dhe rrugësh (*Rruga e Domnorëve*)<sup>72</sup>. Ndoshta me vetë këtë *Domën* në *Redi* lidhet edhe ai *Damniç-Tuz* që gjejmë te Defteri i 1485-ës<sup>73</sup>, me ndryshimin *o < a* dhe prapashtesën sllave *-iç*<sup>74</sup>. Për mendimin tonë prandaj nuk mund të çohet gjetiu kjo *Radina*, sepse i përgjigjet vendit *Redin* të Gruemirës si ubikacion, dhe këtë arsyejon edhe mikrotoponimia e sotme. Pikërisht këtij emri *Redin*, shkruesi i Defterit i bën një kontaminim duke e ndryshuar në *Radina*, siç ka vepruar

65) P. Daka, *Topon.*, s/v. Gruemirë.

66) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/50.

67) AAV, vëll. IX, s/v. *Domëni* «Domini al. Nanreda» dhe s/v *Nanreda*.

68) *Reg. Concess.*, 276.

69) Gelasius, *art. cit.*, 202.

70) *Defteri 1485/fl.* 175.

71) Gelasius (*art. cit.*, 202) ngatërrohet edhe kur vë nën Rrjoll të gjitha fshatrat e Balëxës, bashkë me *Domnin*, kur vetë Rrjoll ishte më 1417 gjysma nën *Bolsa* (Bolsa) dhe gjysma tjetër nën *Lohe* (shih AAV, dok. 2107/45). Në kërkimet e toponomastikës historike duhet pasur parasysh gjithnjë lëvizja e fshatrave, qoftë kur luajnë rretheqark, qoftë kur ngulën në një vend tjetër, zmadhohen ose edhe zhdukën fare.

72) Shih. top. e P. Dakës, H. Koplikut dhe Gj. Shkurtajt në Arkivin e topon. të Sektorit të Gramatikës së Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

73) *Defteri 1485/fl.* 171.

74) S. Pulaha (*Defteri 1485/fl.* 171) e bën një këtë *Damniç-Tuz* me *Kamniç-Tuz* që gjen më 1582, sepse në këtë defterin e dytë osman nuk del një *Damniç-Tuz*, por vetëm *Kamniç-Tuz*. Ndoshta ka të drejtë, dhe atëhere duhet quajtur një gabim i shkruarit.

dhe në raste të tjera. *Naureda* ose *Domni*<sup>75</sup> na treguan rrugën e shtekimit të toponimit, Defteri turk na dha ubikacionin me Rrashin ose Rrahkullajn e sotëm, dhe gjurmët e mikrotoponimisë na vunë në dijeni, deri në një farë mase, për çfarë ka ndodhur në këto kohë. Nga ana e tij, Defteri turk na dha edhe aktin e fundit të këtij *Redin*, të bërë *Radina* dhe të mbetur si troje «të lëna» që punohen nga të tjerë, merret vesh se me angaritë e zakonshme të mesjetës.

9. Një çështje krejt më vete është ajo e vendosjes së *Vrakës*, sepse ajo ndërlikohet me disa keqkuptime që kanë ndodhur lidhur me ubikacionin.

Është bërë e rëndomtë të lidhet *Vraka* e sotme me dy vëllezërit mjekë Kozmaj dhe Damjani, duke u nisur nga një *Sveti Vrač*i të një diplomës të Stefan Dushanit<sup>76</sup>. Ky ubikacion vjen qysh nga Th. Ippen<sup>77</sup> deri te A. M. Seliščev<sup>78</sup>, e edhe më vonë.

Në kadastrin tonë të 1416-17-ës kemi *Santo Auracio*<sup>79</sup>. Në Defterin vitit 1485 del nën trajtën e *Shën(d) Ivra*sh<sup>80</sup>, «timar i Mehmet Çelebiut, rit të Kasapit».

Po a lidhet me të vërtetë ky *Sveti Vrač*i ose *Santo Auracio*, ose edhe me *Vrakën Ivra*sh, me *Vrakën* e sotme? Këtu qëndron pyetja.

Cordignano, në *Regjistri i Koncesioneve*, ku bën edhe indeksin e toponimeve, nuk merr qëndrim mbi të<sup>81</sup>. Po ai këtë mendim kishte pasur një vit më parë, si na thotë E. Armao, i cili bën një përpjekje të re për ta vendosur në *Vrakë*<sup>82</sup>. Ky, në polemikë me Nopçën, që e shpinte *Sant Auracio Jubica* e sotme, duke e lidhur me toponimin tjetër *Veronizza* të Hartës të Coronellit, na thotë se kjo e fundit është një me *Villa Veronica* të një dokumenti të Senatit të Venedikut më 1450, ku tregohet se bënte pjesë e Drisht atëhere<sup>83</sup>, pra kufi me Postripën, aty ku është edhe sot *Vraka*. AAV lidh shprehimisht *Sant Auracio* me *Vrakë*<sup>84</sup>.

Gelasius është i pari që thotë se këto hipoteza nuk qëndrojnë. Ky ndihmë poshtë mendimin e Nopçës, që donte ta përforconte këtë vendosje të *Veronicës* edhe me toponimin tjetër *Lopici* të 1417-ës, duke thënë se *Lopici* nuk është tjetër veçse *Lopçi* i Grizhës<sup>85</sup>, një lagje e këtij fshati të sotëm, dhe për këtë nuk ka dyshim. Ai, përkundrazi, duke u nisur nga *Auracio* të 1417-ës e vendos këtë në vendin e quajtur *Kazmën*<sup>86</sup>, natyrisht duke u nisur nga Kozmaj dhe Damjani.

<sup>75</sup> Toponime *Naureda* dhe *Nanreda* kemi edhe sot në fshatrat *Jerinë*, *Buzujë*, *Hot*, *Bajzë* dhe gjetiu. Populli i jep vështrimin, si e shpjegon P. Daka, si «burim uji në gropë, përrua i thatë». Pavarësisht nga kontaminimi me shqip. *Nanred*, që merr vështrimin e burimit ose reedit (rendit) të ujitjes, fjala duket se është prej s.-kr. *navratiti* «kthej ujët, shpie ujët në një vend».

<sup>76</sup> Thalloczy-Jireček, *Illyrisch-albanischen Forschungen* I, 270.

<sup>77</sup> Th. Ippen, *Mit. d. geogr. Gesell.*, Wien 1904, 47.

<sup>78</sup> A. M. Seliščev, *vep. cit.*, 321.

<sup>79</sup> AAV, vëll. VIII, dok. 2107/11.

<sup>80</sup> Defteri 1485/fl. 347.

<sup>81</sup> *Reg. concess.*, 152-3.

<sup>82</sup> E. Armao, *vep. cit.*, 114 v.

<sup>83</sup> Po aty. Për Nopçsa-n shih *Albanien, Bauten, Trachten u. Geräte Nordalbaniens*. Berlin-Leipzig 1925, 213.

<sup>84</sup> AAV, vëll. IX, s/v. *Vraka*.

<sup>85</sup> Gelasius, *vep. cit.*, 137.

<sup>86</sup> Gelasius, *vep. cit.*, 260.

Shihet se hipotezat janë nga më të ndryshmet, po ne e përjashtojmë fare se fshati i sotëm *Vrakë* lidhet me *S. Auracio* ose me *Shën Ivrash*. Provën e kemi te vetë Kadastrin, sepse aty kufijt e *S. Auracio* dallohen në qartë në afërsi të *Palëvarit*, sot Lagje e Koplikut, sepse aty shënohet shprehimisht se *Palëvari* (Fontana Polvara) e 1417-ës ka si kufij në të anë fshatin e Dobrit, në anën tjetër pikërisht këtë *S. Auracio*: «në vendin e quajtur Kroj i Palëvarit, me kufij më një anë fshatin e *S. Auracio* më anë tjetër fshatin e Dobrit»<sup>87</sup>. Prandaj, duke pasur përpara një regjistrim kadastral, me saktësinë që dihet përsa u përket kufijve (atëherë ky *Palëvari* përfshihej në parasporin e Grizhës), *S. Auracio* duhet të jetë në veri të Grizhës, jo në jug të saj, dhe nuk mund të vendoset në asnjë mënyrë në *Vrakën* e sotme, sepse midis Dobrit dhe *Palëvarit* janë fshatra të tjerë për të arritur deri te *Vraka* e sotme. Nga ana tjetër ky *S. Auracio* pajtohet edhe me toponimin tjetër të Defterit: *Shën Ivrash* dhe hyn në një timar me Dragovojë dhe *Ballezë* (*Balvezi*), dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vendin e tij<sup>88</sup>. Me gjithë lëvizjet që kanë pësuar fshatrat në përgjithësi, nuk mund të mendohet se *Palëvari*, *Dobri* dhe *S. Auracio* të kenë luajtur të gjitha njëheri, prandaj *Vrakën* e sotme duhet ta kërkojmë në një vend tjetër më 1485, dhe të përcaktojmë se ku është *S. Auracio* ose *Shën Ivrashi* në këto dy kadastra.

Kemi pra, më 1485, një *Gorna Voroniça*<sup>89</sup> ose *Voroniça e Sipërme* që vjen këndeje Gruemirës si rrjeshtim në timarin e Silahdar Iskenderit dhe një *Aşaga Voroniça* ose *Voroniça e Poshtme*, e cila është afër fshatit *Grudë* me pesë shtëpi<sup>90</sup>. Kjo *Grudë* duhet të jetë *Grudëfusha* ose *Grudëkeqja*, lagje e Grizhës, aty ku gjinden edhe patronime *Gruda* në dy kadastrat.

Del pyetja atëhere pse nuk kemi një *Vrakë* ose një *Voroniçe* në Kadastrin e 1416-17-ës. Shpjegimin e kësaj ndoshta mund ta japë etnografia: *Vraka* ka sajuar në kohë një tërësi me fshatrat *Gril* dhe *Boriç*, dhe prandaj ka të ngjarë që *Vraka* e 1417-ës ose është përfshirë në njësinë *Gril* që është aty, ose ndoshta edhe një krijim në këtë kohë.

A mund të ketë një tkurrje të fjalës *Veronica-Veronizza* dhe bërë *Vrakë*, si e mendon E. Armao<sup>91</sup>? Nuk mund të besohet një gjë e tillë, sidomos kur E. Armao nisat nga *Auracio* < *Veronizza* / *Veronica* < *Vraka*, pra vetëm nga prapashtesa e *Veronica* të vitit 1450. Shumë-shumë vetë administrata mund të kishte bërë ndonjë zëvendësim me toponimin, por *St. Auracio* përmendet vazhdimisht qysh më 1417 deri në kadastrin turk si *Shën Ivrash*, prandaj nuk është zhdukur në këtë ndërkohë, dhe natyrisht nuk lidhet me *Vrakë*, e cila në atë kohë thuhet edhe se shkon me Drisht. Lëvizja e kufijve midis Shkodrës dhe Drishtit, duke pasur parasysh konfliktin që kanë pasur në atë kohë dy komunat, shkon sipas vijës së kufijve të tyre, pra duhet të jetë në këtë rreze, aty ku është *Veronika* ose *Vraka*. Po t'i sillemi mikrotoponimisë, *S. Auracio* dhe *Shën Ivrash* e kanë lënë gjurmën e tyre, por jo në këtë vijë demarkacioni, as në

87) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/61: «in luogo dicto a Fontana Polvara, i suo confini sie de l'un ladj la villa de Sancto Auracio, da l'altro ladj la villa de Dobrea».

88) *Defteri 1485/fl.* 344-347.

89) *Defteri 1485/fl.* 145.

90) *Defteri 1485/fl.* 75.

91) E. Armao, *vep. cit.*, 114 v.

Kazmej si mendon Gelasius<sup>92</sup>, por në *Shnavrash të Kaldrunit*, pikërisht kufi me Dobrin, ku kemi edhe *Suka e Shnavrashës*<sup>93</sup>, pra *Sant Auracio* < *Shën Ivrash* < *Shna(i)vrash* < *Shnavrash*. Ky është toponimi që ruan kujtimin e *Sveti Vrači* < *Shnavrash*<sup>94</sup>, duke u nisur nga një *Auracio* që mund të lexohet edhe *Avraccio* (u : v), siç kemi raste në kadastër.

Pastaj duhet të theksojmë se, megjithëse Coronelli e shënon *Veronizza* më 1685, dhe Armao na bie dokumentin tjetër me *Veronica* (*Veronika*) më 1450, dhe në Defterin kemi *Voronice*, para Coronelit gjendet toponimi i plotë *Vuraka* te Bolizza<sup>95</sup>, dhe kjo është *Vraka* e mirëfilltë, prandaj duhet të përjashtohet fare kjo tkurrje e emrit *Veronika* në *Vrakë* si mendon Armao<sup>96</sup>.

Përkundrazi, si e vë në dukje Gelasius, *Vraka* është një përrua që del rreth Malit të Maranajt, por që shteron në gusht. Ky autor shton se duket se prej këtij përroi merrte dikur emrin pjesa e lagur prej tij<sup>97</sup>. Ngulimi i disa shtëpive të ardhura prej viseve të Malit të Zi në *Vrakë*, që i ka dhënë shkas të lidhet me *Sveti Vrači* të Diplomës së Stefan Dushanit, ka ndodhur përkundrazi rreth vitit 1820, si e dëshmojnë Gelasius dhe tradita<sup>98</sup>.

Nga ana tjetër, duke pasur toponimin *Vuraka* më 1612, *Sheun e Vrakës* dhe mikrotoponime të tjera si *Vrakae* për tokë e kopshtije në Vorfë të Postripës, etj., pra në rrethin e fshatit, dhe patronimin *Raka* në Grizhë qysh më 1417 dhe gjetiu, shihet edhe më mirë se këto anë e kanë ruajtur këtë toponim, dhe kjo tregon për mendimin tonë se *Vraka* ishte aty si toponim dhe nuk kishte të bënte fare me *S. Auracio* ose me *Shën Ivrash*, fshat sot i zhdukur, që nuk ka lënë veçse ndonjë gjurmë në mikrotoponimi.

Po ta shtyjmë më tutje vështrimin në pikëpamje të gjeografisë gjuhësore, ky emër duhet të sajojë një grup me *Uraka*, prej të cilit kemi disa makro- dhe mikrotoponime; e gjejmë përsëri edhe si hidronim në vise të tjerë të Shqipërisë (*Lumi i Urakës* në Kthellë, *Uraka* ndërmjet Laçit dhe Bruçit, *Uraka* në Librazhd dhe gjetiu, pa folur për mikrotoponimet), në emra dhe mbiemra. Hidronimet, siç dihet, janë më të qëndrueshme, prandaj *Vraka*, siç e thekson me të drejtë Gelasius, nuk mund të lidhet me dy vëllezërit Kozmaj dhe Damjani.

Por *Veronizza* shënohet, në hartën e Coronellit, pikërisht aty ku gjindet sot *Vraka* e mirëfilltë<sup>99</sup>. Atëherë, duket se shkruesi turk nuk bën gjë tjetër veçse kontaminimin e kësaj *Veronike* në *Voronice*, ose ai vetë i vë *Vrakës* një emër të ri *Voronice*, ndërsa kartografi venedikas Coronelli ndjek këtë traditë administrative duke e regjistruar në hartën e tij si *Veronizza* më 1685, përkundrazi Bolizzas që shënon emrin e vendit *Vu-*

<sup>92</sup> Gelasius, *vep. cit.*, 268.

<sup>93</sup> P. Daka, *Topon.*, s/v *Kaldrun*.

<sup>94</sup> Ky kujtim i mjekëve sllavë gjendet edhe në një Kishë të Shkodrës të vitit 1417: «ecclesia Omnium Sanctorum vocata in lingua sclava Sancte Vraze» (shih AAV, dok. 2064, 2067, 2045/20, 25). Edhe kjo tregon se është një dyzim, kishtar këtë herë.

<sup>95</sup> I. Zamputi, *Relacione I*, 3/303.

<sup>96</sup> E. Armao, *vep. cit.*, 114, v.

<sup>97</sup> Gelasius, *art. cit.*, 268.

<sup>98</sup> *Po aty*,

<sup>99</sup> E. Armao, *vep. cit.*, harta.

raka<sup>100</sup> sot *Vraka*, dhe për këtë të fundit nuk mund të ketë dyshim, pse me tkurrjen e -u-së, e kemi edhe sot *Vraka*.

10. *Shukovik-Tuz*<sup>100a</sup> shtron më së pari çështjen e ubikacionit të Kadastrin e 1416-17-ës. Aty gjejmë një *Sochiovina Sochovina*<sup>101</sup>, për tokë afro 40 arësh (134 hektarë) në afërsi të Kaldrunit<sup>102</sup>, që u është dhënë në Tuzëve në këtë kohë. Vetë gjymtyra e dytë -*Tuz* te Defteri i 1485-të shpie ta kërkojmë ubikacionin e *Sochovina*-s te *Shukovik-Tuz*, sepse siç e vumë re më sipër, edhe me 1417 këtë vend e kanë Tuzët. Në këtë rast kemi një kalim të thjeshtë nga prapashtesa sllave -*vina* e shkruar venedikas, në prapashtesën tjetër sllave -*vik* të shkruarit turk.

Ka shumë të ngjarë që në këtë *Sochovina-Sochiovina*, sipas regjistrimit të shkruarit venedikas, të kemi në rrënjë fjalën *socho*. Kjo fjalë shumë e shpeshtë në këtë kadastrë, lidhet me tipin e tatimit të kohës së Stefan Dushanit *soku*. Më 1417 ka marrë vështrimin e detyrimit feudale «me të shtatë», siç e vë re I. Zamputi<sup>103</sup>. Në krahasimin më rrënjor *shuk-* te *Shukovik-Tuz* të shpie toponimia e sotme, pse po në këtë zonë kemi *Shuket e Kurhotit* etj., ashtu siç gjindet edhe tatimi binjak i solot *obroku (socho et obrocho)*, në toponomastikë: *Obroshe* «ara» në Kopllak të Poshtëm. Me pushtimin turk, duke u zhdukur këto dy lloje tatimesh edhe vetë emrat u zhdukën fare, por duke lënë në toponimi ndonjë gjurmë, siç pamë rastin të *Shuket e Kurhotit* (që nuk mund të lidhet me *Shuk* < *Pashuk*).

Nuk del pse shkruarit turk të ketë kaluar prej *shukovinës* në *shukovën*.

11. Toponime me prapashtesat -*ik*, -*iq*, e -*iç* dalin disa në këtë kadastrë për këto vise, e edhe kjo lidhet me praktikën sllavizante të shkruarit në fjalë. A. Xhuvani e E. Çabej theksojnë se kjo prapashtesë është gërshtuar me sajime të substantivuara si *balik* (nga *balë*), *jetik* (nga *jetë*) etj., dhe me emra fisesh o vendesh që gjenden në ilirishten si *Oplica Lopsica*, etj. Por, me to, shtojnë autorët në fjalë, ka edhe sajime të numërimit të huaj, sllav ose turk, si *Belik*, *Golik*, etj.<sup>104</sup>. Edhe M. Domi e ka marrë këto kohët e fundit këtë tezë, duke i shtuar edhe mjaft materiale të reja nga fusha e gjuhësisë dhe e toponomastikës<sup>105</sup>. Nga ana tjetër

100) I. Zamputi, *Relacione*, I, 3/303.

100a) Defteri 1485/fl. 139.

101) AAV, vëll. VIII, dok. 2076, 2107/14, 16.

102) Vendi dhe rrethi i thotë Kaldrun. Nga përdorimi i qytetit dhe i disa viseve të tjera, në letërsi ka hyrë Kaldrun. Më 1417 regjistrohet *Caldiron*, me 1418 *Kadrun*.

103) Këtë vështrim i konstaton I. Zamputi këtij tatimi në një studim të tijin, që është duke përgatitur për shtyp: *Shkodra dhe rrethi i saj në njëzet vitet e para të pushtimit venedikas (1396-1416)*.

104) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962, 50 v.

105) M. Domi, *Prapashtesa ilire dhe shqiptare. Përkime dhe paralelizma në «Studime filologjike»* 4(1974) 167 v.

I. Popović i shqyrton prapashtesat me *-ik* në dy anët e prodhimitarisë së tyre, në viset malazeze dhe shqiptare<sup>106</sup>.

Ne pamë më sipër *Shukovik-Tuz*, dhe nuk kemi sepse të kthehemi më mbi të, por këtu do të përmendim *Kuqik-Tuz*, që është një emër tjetër që merr prapashtesën *-ik* në Defterin e vitit 1485<sup>107</sup>. Si vendosje nuk mund të ngatërrohet me Kuçin e sotëm në breg të Drinit, dhe Pulaha, duke pasur parasysh rrjeshtimin e fshatrave, e vendos me mjaft të drejtë këtë *Kuqik-Tuz* buzë Liqenit të Hotit<sup>108</sup>.

Duke pasur parasysh, në rastin e parë, kalimin  $\zeta < q$ , ky *Kuqik-Tuz*, duhet të jetë *kuq*, siç kemi në Shqipërinë veri-lindore tërë një trevë të përkthyer *Krasniqe*, sepse edhe aty gjindet *Kuq* në mikrotoponimi. Këtë emër duhet ta fusim prandaj në një grup me atë të Shqipërisë verilindore, se sa me grupin e *Kuçit*. Mendimet e specialistëve mbi identitetin e këtyre dy *Kuçave*, me  $\zeta$  dhe me  $q$ , janë të ndara. Por, ne na intereson vetëm prapashtesa *-ik*, që i bëhet emrit *Kuq*, regjistruar *Kuqik*.

Nga një *-iq*, *-iç* u shton shkruesi edhe disa toponimeve të tjera të njohura, si *Puliq*, në një timar me Melgushin, Dobraçin e Bregbunës, Shirqin, etj.<sup>109</sup>; *Puleç* (*Puliç*) është në një timar me Egçin<sup>110</sup>; *Do Branci*, që kemi më 1417 si fshat me vllëh, bëhet *Dobraniç*<sup>111</sup>; *Niksh* bëhet *Nikshiq*<sup>112</sup>; një *Malaj* bëhet *Maliç*<sup>113</sup>; *Domnet* e Grizhës ndoshta lidhen me

106) I. Popović, *Neki gentilni i njima srodni kod Crnogoraca i Arbanasa* në «Radovi» knj. 2, Sarajevo 1954, 55 v. Ai thotë se fjala *plemenik*, e lidhur me *pleme* «fis», tregon «pjestarin e fisit» serbokroatisht, ndërsa fjala shqipe *fisnik*, që gjen përdorim në Mal të Zi, Hercegovinë, Maqedoni dhe gjetkë, ka vetëm vështrimin «bujar, dorëdhënë», siç e ka në shqipen, dhe nuk i përgjigjet *fis* «pleme». Ky përfundon duke thënë se në këto raste «prapashtesa shqipe nuk ka prejardhje sllave». Ne e prumë këtë shembull për të parë dallimin e tyre lidhur me vetë konceptin *fisnor*, dhe shtrirjen e fjalës *fisnik* edhe në vise që i kapërcejnë kufijt e Shqipërisë në veri dhe në lindje. Por, njëkohësisht duhet shënuar edhe se kjo prapashtesë të fjala shqipe *fis* është *-nik*, jo *-ik*, si mendon Popović.

107) *Defteri 1485/fl.* 342.

108) Por, nga ana tjetër, nuk mund të vihet vija e barazimit midis *Kuçit* të 1417-ës dhe atij të 1485-ës (*Defteri, Hyrja*, fq. 20), sepse *Kuçi* i parë lokalizohet fare mirë në Mbishkodër, nën *Bolc*, (*Cucci soto Borsa*), siç është parë me kohë, dhe *Kuçi* i Defterit ka të ngjarë të jetë *Kuçi* i sotëm, në Breg të Drinit, por që nuk ekzistonte më 1417. Ky *Kuçi* i 1485-ës rrjeshtohet në një timar me fshatra të Nënshkodrës (fl. 152). Një ngatërrësë e tillë ndërmjet ubikacionit në Mbishkodër dhe në Nënshkodër ka ndodhur edhe me *Mazarak-un* e 1485-ës, që bëhet një me *Zamarak-un* e 1417-ës, natyrisht duke i supozuar një metatezë *maz-zam* (*Hyrja*, fq. 20). Po, *Mazaraku-Mazrreku* rrjeshtohet në Defter në Nënshkodër, dhe *Zamarachi* i 1417-ës është në Mbishkodër, prandaj këtu kemi të bëjmë jo me *Mazrrekun* por me *Gjamaratin*, poshtë Shkallës të Bishkasit edhe sot. Edhe te relatorët kemi *Giamarat* (I. Zamputi, *Relacione I* 29/170, 170 v, 172), *Giamarati et Pulati* (Id., *ibid.*, 30/179 v), *Giamarat* (Id., *ibid.*, 32), *Zamarati* (Id., *ibid.*, 39/66), etj. Luhatja midis *Gjamarat-Çamarrat*, që shihet edhe në këto regjistrime, është edhe sot, sepse *Gjamarat* e quajnë këtë fshat viset e Malsisë së Madhe, dhe *Çamarrat* ose *Çamarat* Rranzat.

109) *Defteri 1485/fl.* 141-3.

110) *Defteri 1485/fl.* 138-9.

111) AAV, vëll. VIII, dok. 2107/65: «E da saure che le molte case sul terren de Scutari de la banda de Soura, le quale se clama *do Branci e Vlach*... non son gente stabelle, anci son pegorarj che va e vien». Po *do Branci*, për fshatin e zhdukur sot në Shëngjin (*in la Medoa* — dok. 2158/51) dhe që përsëritet *do Brance* dhe *do Branci* (dy herësh) në dok. 2158/46, do të bëhet *Dobraniça* (në Malet Mjet) më 1485 (*Defteri 1485/fl.* 161).

112) *Defteri 1485/fl.* 138.

113) *Defteri 1485/fl.* 129.

*Damniç*, siç e pamë më sipër; fshati *Voksh* bëhet *Vokshiq*<sup>114</sup>, dhe po aty një *Braza* më 1417<sup>115</sup>, nga *brac*, siç e kemi edhe në antroponimi, bëhet *Braça*<sup>116</sup>, etj.

Kështu bëhet edhe më e plotë pasqyra e ndërhyrjeve që bën shkruesi Sulejman Abdullah në Defterin osman.

12. Sllavizimi i epiteteve është i përgjithshëm në këtë Defter. Nuk kemi veçse ndonjë rast të rallë epitetesh të dhëna turqisht, si te toponimet *Aşaga Voroniça*<sup>117</sup>, *Bjelopolje küçük*<sup>118</sup> e ndonjë tjetër, por edhe këtu toponimit të parë i kundërvihet epiteti tjetër sllavisht *Gorna Voroniça*<sup>119</sup>.

Epitetet *Dolina* dhe *Gorna* përcjellin këtu jo vetëm emrat sllavë të mirëfilltë, por edhe ato të truallit shqiptar si *Trushi*, sepse dy *Trushat* e Defterit shënohen *Dolini Turmshi* dhe *Gorni Turmshi*<sup>120</sup>, me 11 dhe 4 shtëpi përkatësisht më 1485. Në Kadastrin e Komunës më 1417, këtyre u përgjigjen 3 *Trusha*: *Trompsi grandj* ose *Trushi i madh* me 67 shtëpi<sup>121</sup>, *Trompsi de Vucho* ose *Trushi i Vukës* me 4 shtëpi<sup>122</sup> dhe *Trompsi Vechi* ose *Trushi i vjetër* me 4 shtëpi<sup>123</sup>.

Shkruesi i Defterit osman ndjek mënyrën e vet; nuk përkthen me ndonjë *veliki*, as me *stari*, por shënon *Dolini Turmshi* për *Trushin e madh* dhe *Gorni Turmshi* për *Trushin e sipërm* ose të *vjetër*, ndërsa *Trushi i Vukës* nuk del më; nuk dihet me cilin është përfshirë apor është zhdukur. Po t'i përmbahemi Kadastrit të vitit 1416-17, *Trushi i vjetër*, si quhej atëhere edhe sot, duhej përkthyer me *stari*.

S. Pulaha shënon me plot të drejtë për këto: «cilësimi i tyre si *Dolini* ose *Gorni* është një emërtim i ri nga shkruesi i Defterit, sepse është e pamundur që toponimet e lartpërmendura të jenë sllavizuar midis vjeteve 1416-1485, në një periudhë kur në Shkodër prej kohësh nuk ekzistonte sundimi serb»<sup>124</sup>.

\*

Këto mënyra të ndërhyrjes administrative janë të njohura në toponomastikë edhe në vende të tjera, dhe dihen ligjet ose rregullësitë që qëndrojnë në themelin e ndryshimit të tyre. Dy kadastrat tona na lejojnë t'i konstatojmë dhe t'i dokumentojmë më mirë, të mos qëndrojmë në fushën e hipotezave. Krejt përkundrazi, këtu ndjekim të tërë një praktikë.

114) *Defteri 1485/99*.

115) AAV, vëll. VIII, dok. 2157/51.

116) *Defteri 1485/fl. 129*.

117) *Defteri 1485/fl. 75*.

118) *Defteri 1485/fl. 216*.

119) *Defteri 1485/fl. 145*.

120) *Defteri 1485/fl. 152 e 153*.

121) AAV, vëll. VIII, dok. 2158/87.

122) AAV, vëll. VIII, dok. 2158/36.

123) AAV, vëll. VIII, dok. 2158/36.

124) S. Pulaha, *Defteri*, vëll. I, *Hyrja*, f. 5.

Në qoftë se duam t'i grumbullojmë këto toponime sipas kriterit gjuësor, atëhere mund të bëjmë grupimin si vijon:

a) Raste përkthimesh të thjeshta, me një fjalë zëvendësime trajtash prej një gjuhe në një tjetër, siç pamë te fjala *Podol* për *Lugun e Egçit* në *Bregut*. Duke ndjekur po këtë kriter, *Lugjet e Pultit* ose *Lugu i Pultit* thehet në *Dola* (pika 1). Po kështu pamë edhe në hyrje se në Defterin e Dibrës të vitit 1467, *Guri i Bardhë* bëhet *Bilakamin*, ndërsa në dokumente të tjera del *Pietra Bianca* ose *Guri Bar*.

b) Raste zëvendësimesh ose dyzimesh, duke i dhënë emrit të vjetër një emër të ri në një gjuhë tjetër, kemi edhe këtu:

*Bishtrrrjoll* është bërë *Barsh*, emër që ne mendojmë se mund të lidhet me *Melishtë*, sepse meli ishte kultura e tij kryesore më 1417, si e shënon kadastri (pika 6). *Lohja* bëhet *Luk* (pika 4).

Tjetër zëvendësim duhet të jetë ai i *Vuraka* me *Voronçe*, që e gjejmë dhe më vonë te Harta e Coronellit, po Bolizza do të shënojë *Vuraka* (pika 9), për *Vrakën* e sotme.

c) Kompozitat janë një kategori më vete. Këtu kemi rastin tipik të *Shkripolit* (pika 2), që nuk është tjetër veçse *Shkreli* i plotësuar me një gjymtyrë të dytë -*polje* «*pllajë, fushë*»: *Shkri(l)pol* me kalimin  $e < i$  (pika 2).

Një tjetër kompozitë është ajo e *Bjeli Brod*, që duhet t'i përgjigjet *Varbardhit* ose një *Vaut* të *Bardhë*. Ndryshimi i kushteve gjeomorfologjike dhe i veshjes bimore të zonës ka bërë të humbasë kuptimi i një vaut në këto anë, duke mbetur vetëm në ndonjë rast sporadik si *Rruga Vaut* (pika 5).

c) Epitetet në këtë defter janë të gjitha sllavisht, me përjashtim të ndonjë rasti të rallë turqisht. Epitetet kryesore sllavisht janë *Dolina*, *redna*, *Gorna*, që u vihen pa dallim emrave të truallit shqiptar, si i pamë në rastin e *Trushit të Madh* dhe të *Vogël* (pika 12), te *Voronçe* (pikat 9-12), etj.

d) Kakografitë mesjetare, të pashmangshme në çdo kadastrim të bërë nga të huajt, nuk mungojnë edhe këtu. Kemi *Ballézën* e sotme të Grihës bërë *Balvez* ose *Baloz* (pika 7). Raste të tjera janë ato të *Radina* për *tedin* (pika 8).

*Do Branci* (dy fshatra regjistruar në katër raste dy gjymtyrësh më 1417, dhe ndryshuar më 1485 në *Dobraniç* dhe *Dobraniça*) paraqet një rast tjetër kakografie (pika 12).

*Stoici-Istulush/Istolosh* për *Shtoj-c(z/ë)* është një tjetër kakografi (pika 3). Si kakografi duhet të merret, për mendimin tonë, edhe *Sochovina-Shukovik* (pika 10), duke kaluar prej një sllavizimi në një trajtë të similar shqipe të temës, por duke i shtuar një prapashtesë sllave përfundimtare. Po kjo vërejtje vlen edhe për fshatin *Braza-Braca* bërë *Braça* (pika 12).

e) Prapashtesat me *-ik*, *-iq*, *-iç* tregojnë edhe këto ndërhyrje. Kemi *Shukovik*, *Kuqik*, pastaj *Damniç*, *Maliç*, *Dobraniç-Dobraniça*, *Vokshiq*, etj. (pika 12).

\*

Mënyra e regjistrimit të shkruarit turk, Sulejman Abdullahut, siç pamë në dukje më sipër, ndjek një traditë më të vjetër. S. Pulaha shkruan se ky ishte «prej robërve të liruar të Vezir Mahmud Pashës»,

gjë që tregon qartë Defteri i vitit 1485<sup>125</sup>. Natyrisht se duke qenë rob liruar nuk duhej të kishte prejardhje turke, dhe Pulaha shton se duhej të ishte me kombësi sllave. Ne vumë re, përkundrazi, se duhej të ishte biling dhe prej viseve të vetë Sanxhakut të Shkodrës ose viseve të afërta duke analizuar mënyrat e ndërhyrjeve të tij.

Ne na duket se pika që e lidh këtë traditë sllavizante me sundimin e mirëfilltë të Stefan Dushanit është vetë Kadastri venedikas i 1416-17-ës. Ne nuk e zëmë ngoje deri këtu, pse kështu do të hynim në një lëm tjetër në atë të antroponimeve, të cilin nuk ia kishim vënë detyrë vetes ta ndiqnim, megjithëse ka edhe kjo shembuj të shumtë. Ne do të kufizohemi këtu vetëm me ndonjë shembull që e lidh këtë traditë me kohët e mëparshme.

Pamë se Oborri i Sinjorisë venedike në Shkodër kishte një shkruar Thoma Shkjaun, birin e Dobrosllavit<sup>126</sup>, i cili jetonte në qytet dhe mban-te edhe fshatra me cilësinë feudale të kreut në Koplik, Kaldrun etj. Në Regjistrin e Koncesioneve që përcjell kadastrin, ky Thoma Shkjau dë-disa herësh ndër aktet që bëhen aty, si edhe në dokumente të tjera.

Koncesioni i 10 marsit flet mbi ndarjen e tatimit për vreshtat ndër-mjet lagjeve të Koplikut (*sexterj*). Ndër delegatët që përmenden aty të ardhur nga Kopliku në Shkodër për këtë punë, është edhe emri i *Andrea Somilla seu Somilichi*. Po ta ndjekim po këtë emër në kadastrin gjejmë trajtat: *Somilli*, *Somilla*, *Somelichi*, *Somilichi* (në fakt, në fshatin e Koplikut, regjistrimi është: *Andrea Somilli overo Somilichi*, dhe kjo është trajta italisht kundrejt së parës dhënë latinisht)<sup>127</sup>. Shihet prandaj se ky italianizim dhe sllavizim njëkohësisht niset nga *Somilli* < *Shëmhilli* patronim i rëndomtë në viset shqiptare, nga i cili dilet te *Somilichi*, me sllavizim të qartë.

Ky kalim i mbiemrit bëhet në sferën e këtij Thoma Shkjaut, në pronat që mban ai si feud. Në fshatin tjetër *Kaldrun*, që mban përsëri ky Thomaj, kemi prapë: *Radin Grichigna* dhe *Novak Grichignich*, *Stefan Grichignich*<sup>128</sup>, të tre po në atë fshat, ndoshta edhe farefis, dhe kjo e bën edhe më të qartë dukurinë.

E thamë edhe më sipër se këto patronime dhe antroponime duhet marrë në tërësinë e tyre dhe bërë objekt i një studimi të veçantë<sup>129</sup>, por mënyra e veprimit na tregon këtu sa e fortë ishte kjo traditë në raste të caktuara dhe si vepronte.

\*

Si përfundim, tradita sllavizante e administratës, e me të edhe e fesë, hetohet fare mirë në këtë kalim të po të njëjtit shekull nga defteri venedikas në defterin turk dhe shihet edhe se pasojat e saj ndjehen edhe më 1416-17. Kjo traditë do të jetojë edhe për ndonjë shekull nën

125) *Defteri 1485/fl. 209 (f. 49)*.

126) *AAV*, vëll. VIII, dok. 2084: «Et hoc in presencia ser Thome sclauo scribe curie jn ydiomate Slavovo».

127) *AAV*, vëll. VIII, dok. 2107/18.

128) *AAV*, vëll. VIII, dok. 2107/12.

sundimin turk, siç shihet edhe në Defterin e Dibrës të vitit 1467, e do të shihet edhe më vonë në Defterin tjetër osman të Shkodrës më 1582, të cilin ne sa e prekëm.

Nopcsa ka pasë shprehur mendimin se sllavët kanë vepruar kurdoherë, ndër vendet e zëna prej tyre, me përkthimin e emrit fillestar vendas ose zëvendësimin e tij. Pushtimi sllav është shtrirë në këto vise për disa shekuj, edhe pse me ndërprerje, dhe Bodini i Rashës, (shek. XI) ka pasur edhe si kryeqytet Shkodrën, pastaj vijnë njësitë shtetërore të mëvonshme serbe, deri te Stefan Dushani.

Natyrisht se këto reflekse të kohës së pushtimit turk, edhe pse nuk kemi kadastrime të kohës sllave por vetëm ndonjë diplomë koncesionesh, tregojnë për një veprim pak a shumë sistematik të shtetit dhe të fesë, dhe shpesh këto toponime të përkthyer ose të zëvendësuar, ose edhe të shndërruara me anën e kakografisë si më afër emrave sllavë, kanë kaluar edhe në gojën e popullit, dmth kanë mbetur të tilla, me ato ndryshime që u bëhen nga ana e folësit vendas, që ka një gjuhë të ndryshme nga ajo zyrtare. Por, edhe pse kanë mbetur me shumicë, sidomos në makrotoponimi, janë gjithmonë apelativa që kanë pësuar ndryshime gjuhësore në gojën e shqiptarëve.

Shqiptari ishte i detyruar nga administrata, në kontaktet që kishte me shtetin, me fiskun sidomos, e natyrisht edhe me feudalë serbë ose të serbizuar, të përdorte ato makrotoponime që i ishin imponuar në kadastrin bazë, në aktet e zotërimit të tokave, në regjistrimet që liheshin të depozituara ndër vetë fshatrat ose kryevendet e tyre, si na tregohet edhe nga këto dy kadastra, kur referojnë për hollësi në defterët e fshatrave, ose kur paraqiten dokumente për miratimin e pronave ose të zotërimeve. Pra, administrata ose fisku, qoftë edhe proniari, me atë emër të ri i njihnin këto fshatra, dhe një praktikë e gjatë shekullore i zhduku emrat fillestarë vendas, shumë-shumë duke i lënë në ndonjë rast në mikrotoponimi. Shpresojmë se do të kthehemi përsëri mbi këtë temë.

Një gjë vlen për të gjitha këto sa thamë këtu, se, jashtë pushtimit sllav, në kohën që shkon nga pushtimi venedikas deri te sundimi i gjatë turk, kjo traditë sllavizante nuk e kishte më atë forcën e përparme të përdorimit të gjatë dhe të fiksimit të këtyre termave, dhe kështu rastet e ndërhyrjes, edhe pse vazhdojnë, nuk patën më jetë të gjatë në toponomastikën e Shqipërisë. Tjetër janë lëvizjet e vetë fshatarëve dhe bartjet e emrave sllavë nga një vend në tjetrin, tjetër janë huazimet e njohura patronim-toponim ose toponim-patronim. Këto bartje vërtetohen për arbëreshët edhe në vetë ngulimet e Moresë ose të Italisë së Jugut.

Këtu ne shqyrtoam një pjesë të këtyre toponimeve që lejojnë krahasimin, por një shqyrtim më i imtë nxjerr në dritë dhe raste të tjera, që mund të bëhen objekt studimesh të tjera në këtë fushë.

129) Interesi i krahasimit të antroponimisë bëhet edhe më i madh kur shohim se në këtë kohë dalin edhe patronime të zhdukura në kohët tona, si *Kërshndella* (Defteri 1485/fl. 166), të cilat me kohë janë zëvendësuar me patronimin sllav *Bozhiq*, *Bozhik*, që do të thotë po ajo gjë. Dhe kjo praktikë nuk ka mbetur pa kaluar edhe në toponimi, sepse emërtimi *Bozhiq* gjindet edhe në makro- dhe mikrotoponimi.

## Résumé

CAS D'INTERVENTION DANS LA TOPONYMIE  
DU CADASTRE DE L'AN 1485 A SHKODËR

Les deux cadastrages de Shkodër, effectués au XV<sup>e</sup> siècle, celui de la Commune en 1416-17 sous les Vénitiens, et l'autre pour tout le Sancak de Shkodër en 1485, six années après que cette ville fût expugnée par les Turcs, fournissent, pour le quinzième siècle, le répertoire le plus riche de toponymes et anthroponymes pour l'Albanie, et, probablement, aussi pour les Balkans. Il va sans dire que ces deux cadastrages ont besoin de confrontations critiques et d'interprétations, compte tenu des difficultés qu'a la phonétique du vénitien dans la transcription des noms albanais, et de plus fortes difficultés encore qu'a l'interprétation de la graphie turque pour rétablir la forme voulue.

Si les vénétisations du premier cadastrage n'ont pas eu la vie longue, étant communes à tout cadastrage fait par des étrangers, les turquisations ne font que s'annoncer alors, surtout dans les dénominations des villes. Au contraire, les slavisations suivent une tradition plus ancienne et plus ancrée dans le pays. Elles sont présentes en nombre considérable dans ce cadastre turc, d'autant plus que son scribe, Sulayman Abdulah, doit être d'origine slave, et probablement bilingue. C'est à ces éléments de slavisation que l'auteur arrête son attention.

Il y examine d'abord les traductions. Elles constituent en fait des substitutions de forme, mais en réalité il s'agit d'assimilation sémantique. Parmi les exemples qu'il analyse, il s'arrête plus longuement à la désignation *Podol-Tuz*, une tenure de la maisonnée *Tuzi* en 1485. La concession de cette tenure à cette maisonnée avait été effectué déjà en 1417, mais alors sous la forme albanaise *Lugi* «vallée, combe», que le scribe slavo-turc traduit correctement en *podol* «vallée» mais il s'agit toujours d'une assimilation sémantique en serbo-croate. Il examine aussi la question contestée de l'identification du site, qu'on a voulu envoyer aux *Lujzi de Koplík* (Valentini, Cordignano, Armao), mais que l'auteur fixe dans le *Lug d'Egç* actuel.

Même traduction aussi pour *Lugu i Pultit*, remplacé par le scribe, cette fois, par le nom s.-cr. *Dola* «vallée», synonyme de *podol*.

Les cas de substitutions spontanées à l'aide de surnoms éliminant ou doublant l'ancien nom dans une nouvelle langue, se retrouvent dans le cadastre.

*Bishtrrjollí*, attesté *Bisti Riola* en 1417, est doublé par un autre désignation *Barsh*, qui ne se retrouve pas dans la microtoponymie du village, ni à son voisinage, cependant que la première y est toujours présente. L'auteur croit que ce doublage doit être en rapports avec le serbo-croate *bar* «millet, panic», avec adjonction du suffixe *-sh*. La justification de ce surnom est dans le cadastre même, le millet ou panic étant la culture principale de ce village, pour laquelle il verse la dîme par feu et par maison.

Une autre substitution est celle du village actuel de *Lohe-Lohja*, attesté dans la documentation comme *Loeia* et même *Loheia*. Dans le cadastre de 1416-17 on a les formes *Lochoy* et *Logoa*, cette dernière offrant une contamination slave par le passage  $h < g$ . Le scribe slavo-turc enregistre *Luk* «poireau, oignon, ail», en empruntant ce surnom à la culture de la région.

Une autre substitution est celle de *Vuraka* < *Vraka* par *Voronice*. Dans le cadastrage 1416-17 figure un *Santo Auracio*, qu'on retrouve dans le cadastrage turc sous la forme de *Shën Ivraash*, qu'on a voulu rattacher aux saints médecins

slaves Cosme et Damien, les *Sveti Vrači*, et l'on a voulu mettre en rapports avec *Vraka*. Pourtant, comme le constate l'auteur, *Santo Auracio* et *Shën Ivrash* ne correspondent point à *Vraka*, le cadastre de la commune indiquant parfaitement sa place, au voisinage de l'endroit où se trouve même actuellement le toponyme *Shnavrash*, contigu du village actuel de *Kaldrun*. Au contraire, le scribe substitue le vrai nom de *Vraka*, qu'on retrouve dans la documentation comme *Vuraka*, par *Voronice*, et ce nom sera repris plus tard, d'un cadastre à l'autre, et même réapparaîtra dans la documentation vénitienne du XVII<sup>e</sup> siècle sous la forme de *Veronizza*.

Les composés sont une catégorie à part. L'auteur analyse tout d'abord le cas du village de *Shkripol* qui figure dans le cadastre turc de 1485. Il observe que ce village de *Shkripol* est divisé en trois parties entre divers timariotes. Les deux autres parties se retrouvent dans le cadastre sous les formes de *Shkriil* et *Ishkriil*. En 1417 on a la forme *Schirelli*, forme actuelle *Shkreil*. Le scribe en fait un mot composé *Shkri(l)pol*, en ajoutant comme deuxième membre le mot serbo-croate *polje* «champ, campagne, plaine» et en contractant l' *-l-*. De ce *Shkripol* on n'a point de traces ni dans l'anthroponymie de ces cadastres, qui comptent plus de 25000 noms, ni dans la microtoponymie actuelle de la région, comme vestige de ces temps. Il s'agit d'une formation du scribe.

Un autre composé est *Bjeli Brod*. En partant du deuxième élément *s.-cr. brod* «gué», on ne retrouve presque rien dans cette région karstique, pauvre en cours d'eau abondants, pour justifier la présence d'un gué. Pourtant, est resté *Bardhuline* pour des terrains dénudés blanchâtres, qui justifie le premier élément. Pour expliquer ce gué on devrait considérer autrement l'orographie de cette région, ce qu'on constate vraiment dans la carte de Coronelli, où la lagune de Hoti figure reliée par un chenal d'aménée des eaux, et à son voisinage se trouve une *Rruga e Vaut* «Chemin du gué», où il n'existe plus ni de route, ni de gué, la lagune occupant tout l'emplacement, actuellement. Alors, la procédure a été simple pour le scribe slavo-turc, il traduit un *Vau i Bardhë* «Le Gué blanc» par *Bjeli Brod*.

Les épithètes du cadastre turc de 1485 sont toutes en serbo-croate, sauf de très rares exceptions près: *Dolina*, *Sredna*, *Gorna*, qu'on met indistinctement aux noms albanais, sans distinction des noms proprement slaves.

Les cacographies médiévales, inévitables dans tout cadastrage fait par des étrangers, ne manquent non plus dans notre cadastrage. On a le village *Ballézë* de Grizhe, mué sous la plume du scribe slavo-turc en *Balvez*, probablement en partant du serbo-croate *balvan* «sumac, *Rhus coriaria*», avec contamination du suffixe.

Un autre cas est celui du village de *Redin* à la Gruemire actuelle, devenu *Radina*. Le village, détruit au temps l'occupation turque (dans le Cadastre 1485 il figure «abandonné, cultivé par d'autres»), n'y figure plus que comme ruines abandonnées. Il s'identifie au *Redin* de Gruemire (*Shkodër*), et à son voisinage se trouvait, dans le cadastre 1416-17, *Domini ouero Naureda*, qui a donné lieu à plusieurs identifications, surtout avec le village du *Domni* actuel dans la Postripe. Pourtant, observe l'auteur, Postripe faisait partie au XV<sup>e</sup> siècle, et même plus tard, de *Drisht*, comme sa région ethnographique propre, et *Drisht* (*Drivastum*) formait alors une commune à part de *Shkodër*, dont on n'a pas de cadastre, malheureusement. Même maintenant, de ce *Domen* au bord du lac, transformé en *Damniç-Tuz* par le scribe turc, on en a les traces dans la microtoponymie.

*Do Branci* aussi (deux villages enregistrés dans quatre cas en deux membres en 1417, et mués en 1485 comme *Dobraniç* et *Dobraniça*) offrent un autre cas de ces cacographies.

*Istulush-Tuz* ou *Istolosh-Tuz* est une autre cacographie du scribe. En fait, en

1417 on a *Stoici* octroyé précisément à ces Tuzi par la Commune de Shkodër. Il s'agit d'une grande étendue, environ 1000 champs (*campi* c'est-à-dire environ 3600 hectares), qui rentrent tous dans le *Bas-Tuzi*. Si l'on cherche l'identification, la microtoponymie donne plusieurs *Shtoj*, dont le nom rappelle la réserve du seigneur. C'est précisément le lieu-dit *Shtojca* ou *Shtojza* qui va de la Fontaine actuelle de Koplík outre la rivière de Rrjollí, à côté de Kaldrun, que se trouve aussi l'emplacement. Une fois l'identification faite, on voit que le scribe a passé de *Shtojci-Stoici* en 1417 à *Stulush/Stolosh* en 1485, en créant une cacographie, plus proche au serbe.

Même cacographie aussi pour *Sochovina-Shukovik* respectivement en 1417 et 1485. Si l'on s'adresse à la microtoponymie, on voit que l'appellatif existe dans *Shuket e Kurhote*, et ailleurs. Le thème *soch-* est l'impôt du «septième» pour les cultures, et il remonte au *soch e obroch* des temps de la domination d'Etienne Dušan sur ces régions. Avec l'occupation turque, a cessé aussi d'exister la raison d'être de ce nom, l'impôt ayant été supprimé pour être remplacé par d'autres redevances et impôts propres au timar militaire. Cependant, ce thème *shuk*, uni à la microtoponymie, conserve la façon d'assimilation de l'albanais qui fait le passage de *s* < *sh*, comme dans *summa* < *shuma*.

Aussi les suffixes *-ik*, *-iq*, *-iq* (*-iç*, *-iç*) décèlent l'intervention du scribe, et l'auteur en cite plusieurs: *Shukovik*, *Kuqik*, *Damniç*, *Maliç*, *Dobraniç-Dobraniça*, *Vokshiq*, etc.

Ces modes de cadastrage suivent, naturellement, une tradition plus ancienne. Sulayman Abdulah était un «prisonnier affranchi», et il doit avoir été bilingue, du fait qu'il sait s'y prendre aux désignations. A la cour vénitienne de Shkodër se trouvait, à cette époque, un scribe slave: «Thomas Sclauo, scriba curie jn ydiomate sclavo». Cette procédure est entrevue nettement, aussi à cette époque, quand ce Thomas transforme les noms de quelques-uns des habitants de Koplík et de Kaldrun qu'il avait en tenure, en formes slaves, comme *Andrea Somilli seu Somillich*, ou *Grichigna* < *Grichignich*. Or, *Somilli* n'est autre que la vénétisation de la forme albanaise *Shëmhilli* (Saint Michel), devenue à son tour *Somilich*, et *Grichigna* part de l'alb. *gryka* «gorges», mué en *Grichignich*.

La procédure est manifeste et se passe de commentaires. Pourtant, comme l'observe l'auteur, ces anthroponymes doivent être pris à part et faire l'objet d'une étude spéciale, d'autant plus qu'on y trouve aussi des patronymes disparus actuellement, mais qui sont présents en 1485, comme *Kërshnella* «Noël», transformés en *Božič* même sens, passés aussi en toponymie et restés tels quels.

→ Ces réflexes retardés du temps de la domination ottomane, quoique n'ayant pas des cadastrages des temps de l'extension des formations étatiques serbes, en dehors de quelque diplôme de concession, indiquent d'une action plus ou moins systématique de l'Etat et de la religion. Souvent même, ces toponymes traduits et remplacés, ou bien transformés au moyen de la cacographie, comme plus proches au serbo-croate, sont restés tels, avec les changements que fait à ces appellatifs la langue du pays, une langue différente de celle officielle.

L'Albanais était obligé par l'administration, dans ses contacts avec le fisc surtout, et naturellement aussi avec des pronoïaires serbes ou serbisés, d'employer ces toponymes imposés par le cadastre de base, les actes de possession des terres, les cadastrages dans les villages mêmes ou dans les chefs-lieux, comme on en a notice dans ces cadastres, quand ils renvoient à ces pièces pour le détail, ou bien quand on produit des documents pour la confirmation des possessions ou des domaines. Il s'ensuit donc que l'administration et le fisc, ou même les pronoïaires, reconnaissaient ces villages ou ces possessions par ces nouveaux noms imposés, et une longue pratique fit disparaître les noms initiaux indigènes, tout au plus en laissant des

traces dans la microtoponymie. Les points de repère documentaires qu'on vient d'examiner font une ample lumière sur cette procédure. L'auteur se repromet de revenir à ce sujet.

Une observation vaut, pourtant, en cela, et c'est qu'au dehors de la domination slave, au temps qui va de la domination vénitienne à la domination turque multi-séculaire, cette tradition slavissante n'avait plus la force antérieure d'un long usage et de fixation de ces nouvelles dénominations. Ainsi, les cas d'intervention, quoique continuant encore par des scribes slavo-turcs aussi dans d'autres cadastrages du pays, n'ont plus une existence longue dans la toponomastique de l'Albanie, tout au plus ils passent d'un cadastre à l'autre, mais les Albanais continuent à dénommer ces lieux dans leur propre langue.

